

139
26

S

20.08.19


RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në 'Financë dhe Menaxhim Risku'


Ofruar nga Kolegji Universitar "Luarasi"

Ekspertëte vlerësimit të jashtëm:

1. Prof As Etleva Bajrami



2. Prof As Artur Ribaj



(Gusht/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në 'Financë dhe Menaxhim Risku'

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Luarasi"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Vendim I Senatit akademik Nr 18, datë 12.03.2018 për riorganizimin e programit Shkresë e MASR Nr 5912/1 prot, datë 13.09.2019 për miratimin e Riorganizimit
4	Titulli i programit të studimit:	Master profesional në 'Financë dhe Menaxhim Risku'
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 Vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
10	Programi ofrohet nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2018-2019
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2018-2019
17	Numri i studentëve	9 studentë të rregjistruar 7 studentë kanë frekuentuar

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MPnë 'Financë dhe Menaxhim Risku'

Kolegji Universitar "Luarasi" është licensuar në vitin 2003 me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 11.09.2003. Fillimisht Kolegji Universitar "Luarasi" është hapur me një Fakultet, Fakultetin e Drejtësisë. Aktualisht ka në strukturën e vet 3 (tre) fakultete.

1. Fakulteti i Drejtësisë
2. Fakulteti Ekonomik
3. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit

Masteri Profesional në "Financë dhe Menaxhim Risku" i ofruar nga Kolegji Universitar "Luarasi" është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nr 308, date 27.07.2012, sipas Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr.347, datë 13.07.2012 me rekomandimet përkatëse. Sipas këtij Urdhri ky program studimi është hapur 90 kredite, me kohë të plotë dhe kohëzgjatje 1.5 vite. Gjuha e Programit të studimit është Shqip. Bashkëngjitur këtij Urdhri jepen edhe rekomandimet përkatëse për këtë program studimi.

Masteri Profesional në "Financë dhe Menaxhim Risku" është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 471, datë 19.09.2016, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 149, datë 31.03.2016, vetëm për studentët që kanë filluar studimet në vitet 2012-2013 dhe 2013-2014, me rekomandimin që ky program studimi të riorganizohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015. Fakulteti përgjegjës është Fakulteti Ekonomik.

Ky program studimi është riorganizuar me Vendim Senati Nr. 18, datë 12.03.2018, i cili riorganizohet me 60 kredite me kohëzgjatje 1 vit akademik. Ky Vendim Senati është miratuar nga MASR nëpërmjet shkresës Nr. 5912/1 prot, date 13.09.2018.

Institucioni i Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Luarasi" është akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr 115, datë 15.12.2017 dhe akreditimi është i vlefshëm deri në 14.12.2023, duke marrë "Certifikatën e Akreditimit" e vlefshme për këtë periudhë akreditimi.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. As. Dr. Etleva Bajrami
2. Prof. As. Dr. Artur Ribaj

Kthim përgjigje e Grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ) mbi konstatimet e Institucionit për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit MP. "Financë dhe Menaxhim Risku" në Kolegjin Universitar "Luarasi"

GVJ i pa me kujdes dhe shqyrtoi çdo përgjigje të Institucionit në lidhje me Draft RVJ e programit MP në "Financë dhe Menaxhim Risku". Në lidhje me këtë përgjigje, GVJ merr parasysh disa prej tyre duke bërë ndryshim në Raportin perfundimtar të vlerësimit të jashtëm. Përgjigja e GVJ për çdo kontestim apo sqarim të Institucionit, e gjeni sa më poshtë:

1. Draft Raporti: faqe 7, paragrafi 1, "...Lidhur me këtë çështje u komunikua nga Institucioni se mospërputhjet ekzistojnë por janë bërë padashje (lapsuse) dhe GVB do të bëjë të gjitha rregullimet në format e raportimit për të pasqyruar me vërtetësi realitetin lidhur me gradat shkencore të PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program".

Përgjigja e IAL: "Evidencat e korigjura janë dërguar me dokumentacionin shtesë me dt. 05.07.2019 (formati excel); vizitës në konkretisht tabela 1, 2, 4, 6, 6/2, 11 dhe 13".

Përgjigja e GVJ: Mospërputhjet në RVB u pranuan nga vetë IAL dhe ata ridërguan evidencat të ndryshuara, kjo është shprehur në RVJ. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

2. Draft Raporti: faqe 7, paragrafi 2: “Fakulteti Ekonomik ka në strukturën organizative si autoritete drejtuese Dekanin dhe Drejtuesit e Departamenteve që janë njësitë bazë. Në FE të KU Luarasi janë 3 njësi bazë në funksion të programeve mësimore: 1. Departamenti i Financë- Bankë; 2. Departamenti i Administrim Biznesi; 3. Departamenti i Ekonomiksit. Fakulteti Ekonomik ka në organizimin e tij edhe organe kolegjiale drejtuese të tilla si: Asambleja e personelit akademik të Fakultetit Ekonomik si edhe dy komisione të përhershme. GVJ gjatë vizitës ju bëri me dije GVB se RVB duhet të citonte me referencë në këtë seksion të raportit evidencën ku përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e këtyre njësive”

Përgjigja e IAL: “Të drejtat dhe detyrat e njësive të përmendura më lart janë ato të përcaktuara në Satutin e dhe Rregulloren e brendshme të KU Luarasi (Evidenca 2 -Statuti dhe Evidenca 3 – Rregullore KUL)”.

Përgjigja e GVJ: GVJ gjatë vizitës bëri me dije GVB se RVB duhet të citonte me referencë në këtë seksion të raportit evidencën ku përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e këtyre njësive. Pavarësisht sqarimeve shtesë të dhëna gjatë dhe pas vizitës në IAL u morën evidenca por në RVB e dorëzuar nga IAL nuk janë evidencat. Megjithatë GVJ nuk e evidentoi këtë si çështje materiale për ta evidentuar në konkluzionet e këtij standardi. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

3. Draft Raporti: faqe 7, paragrafi 2: “Sipas Evidenca 3 “Rregullore KUL” në Nenin 8 të tij evidentohen 4 Komisione të përhershme, ndërkohë që sipas Evidenca 8 “Struktura akademike e FE” evidentohen vetëm 2 komisione. GVJ gjatë vizitës kërkoi të informohet si qëndron e vërteta dhe përgjigja e marrë nga drejtuesit ishte se ende edhe sot janë efektive vetëm 2 Komisione të përhershme Akademike, ndërkohë që në të ardhmen bazuar në nevojat do të shikohet edhe mundësia e ngritjes së dy komisioneve të tjera”.

Përgjigja e IAL: “Evidenca 3 - Rregullore KUL”, i referohet Rregullores KUL në nivel Institucioni, ndërsa “Evidenca 8 -Struktura akademike e Fakultetit Ekonomik” i referohet strukturës së Fakultetit Ekonomik. KU Luarasi ka 4 komisione të Përherëshme, ndërsa brenda Fakulteti Ekonomik janë 2 të tjera: 1. Komisioni i Programeve mësimore dhe zhvillimit të kurrikulave dhe 2. Komisioni i kërkimit dhe zhvillimit shkencor”.

Përgjigja e GVJ: GVJ gjatë vizitës bëri pyetje për këtë paqartësi dhe bazuar në përgjigjen e marrë u shpreh në RVJ. Megjithatë GVJ nuk e evidentoi këtë si çështje materiale për ta evidentuar në konkluzionet e këtij standardi në RVJ. Duke pasë parasysh këtë si edhe rikonsideruar komentimin shtesë të dhënë nga IAL vetëm këto 2 fjali në këtë paragraf hiqen nga RVJ. **Ka ndryshim të pjesëshëm të paragrafit në RVJ.**

4. Draft Raporti: faqe 8, Konkluzionet e vlerësimit, pika 1: “Institucioni duhet të ketë kujdes të përcjellë informacion simetrik për atë çfarë kërkohet përmes kritereve në saktësinë e të dhënave dhe informacion për Fakultetin Ekonomik dhe Departamenti i Financë- Bankë si njësi bazë që mbulon programin në vlerësim. GVJ gjatë vizitës në institucion jua bëri me dije dhe fakti të gjitha mospërputhjet e evidentuara në RVB dhe të krahasuara me të dhënat e evidencave si edhe atyre të depozituara në “Institution Profile” të KU Luarasi në ASCAL. Përfaqësuesit e institucionit u shprehën se do të bëjnë të gjitha rregullimet në format e raportimit për të pasqyruar me vërtetësi realitetin lidhur me gradat shkencore të PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program”.

Përgjigja e IAL: “Sikurse u komunikua me GVJ gjatë vizitës, si dhe në materialet shtesë të Institucionit dërguar me dt. 05.07.2019, (pika 22), në RVB ka patur gabime në numrin evidencave të bashkangjitura, (gjithësej 54), megjithëse emërtimi i tyre ka qënë i saktë. Ky gabim, sikurse u theksua gjatë vizitës është rezultat i ri-numërimit të evidencave në variantin final të RVB (up-loduar në sistem). Ri-numërimi, me qëllim sistemimin e evidencave sipas rëndësisë së tyre, në disa raste nuk është pasqyruar në RVB. Përsa i përket gradave shkencore të PAE dhe PAK, sikurse u theksua më sipër, evidencat e korrigjuara janë

dërguar me dokumentacioni shtesë me dt. 05.07.2019 (formati excel); konkretisht tabela 1, 2, 4, 6, 6/2, 11 dhe 13”.

Përgjigja e GVJ: GVJ gjatë vizitës bëri me dije GVB dhe drejtuesit se RVB dhe evidencat duhet të përcjellin informacion simetrik për atë çfarë kërkohet përmes kritereve të përcaktuara në raportin e vetvlerësimit. Pavarisht se IAL ridadepozitoi evidenca të ndryshuara ashtu siç edhe i citon në komentimin e tij, GVJ i referohet RVB të depozituar pranë ASCAL dhe gjykon me vend ta evidentoj këtë si çështje në konkluzione me qëllim për tu pasë kujdes nga IAL në të ardhmen. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

5. Draft Raporti: faqe 22, standarti 1.13: "Evidenca 38 e cituar në RVB dhe vendosur në databasë të ASCAL i cili pretendohet se është Raporti Vjetor i KU Luarasi për vetvlerësimin e brendshëm të veprimtarisë akademike, shkencore, etj., ku shprehen edhe rekomandimet për të ardhmen, por ndërkohë që është një dokument që ka marrëveshjet e KU Luarasi me Universitete të tjera dhe nuk është evidencë për atë që citohet nga GVB. Nuk gjenden evidenca të publikimit të rregullt të broshurave, buletineve, etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm si edhe mbi të gjitha konstatimi për mungesë të publikimit të prezantimeve në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm të KU Luarasi. GVJ gjatë vizitës evidentoi këtë mangësi."

Përgjigja e IAL: "Sikurse u komunikua me GVJ gjatë vizitës, si dhe në materialet shtesë të Institucionit dërguar me dt. 05.07.2019, (pika 22), në RVB ka patur gabime në numrin evidencave të bashkangjitura, (gjithësej 54), megjithëse emërtimi i tyre ka qënë i saktë. Ky gabim, sikurse u theksua gjatë vizitës është rezultat i ri-numërimit të evidencave në variantin final të RVB (up-loduar në sistem). Ri-numërimi, me qëllim sistemimin e evidencave sipas rëndësisë së tyre, në disa raste nuk është pasqyruar në RVB. Përsa i përket gradave shkencore të PAE dhe PAK, sikurse u theksua më sipër, evidencat e korrigjuara janë dërguar me dokumentacioni shtesë me dt. 05.07.2019 (formati excel); konkretisht tabela 1, 2, 4, 6, 6/2, 11 dhe 13”.

Përgjigja e GVJ: Në RVB nuk evidentohet evidenca e duhur për Raportin Vjetor të KU Luarasi për vetvlerësimin e brendshëm të veprimtarisë akademike, shkencore, etj., ku shprehen edhe rekomandimet për të ardhmen. Gjithashtu në RVB nuk gjenden evidenca të publikimit të rregullt të broshurave, buletineve, etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm si edhe mbi të gjitha u konstatua mungesa e publikimit të prezantimeve në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm të KU Luarasi. Të gjitha këto gjetje GVJ i ka cituar dhe bërë me dije përfaqësuesve të IAL-së gjatë vizitës në institucion. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

6. Draft Raporti: faqe 8, Konkluzionet e vlerësimit, pika 2: "RVB për kriterin 1 tek Standardi II.3 duhet të shprehet me fakte për përpjekjet që kanë bërë për rritjen e cilësisë së stafit akademik, pasi nuk gjenden në RVB elementë sasior apo cilësor që ta mbështesin këtë argument". 2. RVB për kriterin 1 tek Standardin II.3 duhet të shprehet me fakte për përpjekjet që kanë bërë për rritjen e cilësisë së stafit akademik, pasi nuk gjenden në RVB elementë sasior apo cilësor që ta mbështesin këtë argument. Gjatë vizitës në institucion ju bë me dije kjo mangësi dhe përfaqësuesit e institucionit shprehën dakordësinë për mungesën e argumentave në RVB por u shprehën gjithashtu për ekzistencën e një dokumenti që vërteton përmirësimin e bërë prej institucionit dhe e depozituan pranë ASCAL në datë 05 Korrik 2019. Megjithatë, GVJ edhe pas konsultimit me këtë dokument konkludon se në FE ishte punësuar vetëm një PAE me gradë shkencore ndërsa të tjerët ishin me Msc, si konkluzion nga njësisia bazë dhe ajo kryesore duhet të ishte bërë më shumë përpjekje për rekrutim të PAE me grada shkencore dhe tituj.

Përgjigja e IAL: "Konkluzioni duket si jo në linjë me vetë vlerësimin e Kriterit 1 të Standartit II.3 nga GVJ, draft - raporti thekson se: "GVJ gjatë vizitës në institucion bëri pyetje dhe mori përgjigje për angazhimin dhe njohjen e përgjegjësive të njësisë bazë për këtë program. Edhe gjatë takimeve të kryera në departamentin e burimeve njerëzore u konfirmua angazhimi i njësisë bazë gjatë procesit të rkrutimit të stafit akademik”.

Përgjigja e GVJ: Në RVB nuk evidentohen evidenca sasiore dhe cilësore. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion ju bë me dije kjo mangësi dhe përfaqësuesit e institucionit shprehën ekzistencën e një dokumenti që vërteton përmirësimin e bërë prej institucionit dhe e depozituan pranë ASCAL në datë 05 Korrik 2019. Megjithatë, GVJ edhe pas konsultimit me këtë dokument konkludon se në FE ishte punësuar vetëm një PAE me gradë shkencore ndërsa të tjerët ishin me Msc. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

7. Draft Raporti, faqe 8, konkluzionet e vleresimit pika 2: “GVJ edhe pas konsultimit me këtë dokument konkludon se në FE ishte punësuar vetëm një PAE me gradë shkencore ndërsa të tjerët ishin me Msc, si konkluzion nga njësia bazë dhe ajo kryesoreduhet të ishte bërë më shumë përpjekje për rekrutim të PAE me grada shkencore dhe tituj”

Përgjigja e IAL: “Konkluzioni është i paqartë ai krijon përshtypjen se në FE është vetëm një PAE i punësuar me gradë shkencore. Faktikisht FE ka 10 PAE me grada shkencore, ndërsa në programin e akredituar janë 6 PAE me tituj dhe grada shkencore”.

Përgjigja e GVJ: U konsiderua komenti duke bërë risistemim të fjalive për të evidentuar qartë se gjatë vitit të fundit akademik PAE me tituj dhe grada shkencore ishin shtuar vetëm me një PAE me gradë shkencore ndërsa të gjithë të punësuarit e tjerë ishin me Msc, si konkluzion nga njësia bazë duhet të ishte bërë më shumë përpjekje për rekrutim të PAE me grada shkencore dhe tituj. **Ka perifrachim të pjesës së dytë të paragrafit të RVJ.**

8. Draft Raporti, faqe 8, konkluzionet e vleresimit pika 3: “...evidenca nr.11 e depozituar në ASCAL nuk është studimi i tregut”.

Përgjigja e IAL: “Sikurse GVB theksoi në takim, evidenca e paraqitur është një përpjekje e institucionit për të studiuar tregun e programit përkatës, në kushtet e vështirësive që paraqet tregu i arsimit të lartë në tërësi. Nuk ka një format të caktuar të cilit mund ti referohet konkluzioni i mësipërm”.

Përgjigja e GVJ: Studimi i tregut është dokument i cituar nga vet GVB në RVB. Kjo fjali në këtë pikë të konkluzionit nga GVJ është sjellë për të vijuar me evidentimin e asimetrisë në dhënien e evidencave në RVB. Në këtë pikë të RVJ evidentohet se në seksionin Dokumentacioni Përkatës është cituar edhe Evidenca nr. 11 mbi hapjen e programit dhe studimit të tregut duke mos e cituar për cilin kriter është sjellë kjo evidencë. Komenti i IAL-së më sipër nuk i përket kësaj pjese të konkluzionit. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

9. Draft Raporti: Fq.9, paragrafi 1 i vlerësimit të treguesve të matshëm: “Ky program studimi është relativisht i ri dhe numri i studentëve është i ulët por me rritjen e numrit të studentëve numri i pedagogëve të brendshëm do të jetë i pamjaftueshëm”.

Përgjigja e IAL: Natyrisht, me rritjen e numrit të studentëve FE parashikon edhe rritjen e numrit të pedagogëve. Gjithësesi mendojmë se stafi aktual ka qenë i mjaftueshëm për programin në fjalë (gjithsej 7 studentë).

Përgjigja e GVJ: Edhe GVJ ka thënë të njëjtën gjë si IAL. Konstatimi i pamjaftueshmërisë së stafit efektivë në të ardhmen, me rritjen e numrit të studentëve dhe orëve të mësimit gjithashtu mbështetet nga fakti se Ngarkesa e orëve të mësimit që zhvillohet nga PAE është 70.8%. Kjo përqindje është shumë afër minimumit të pranueshëm sepse sipas standartit III.1, kriteri 2: “Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve.” **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

10. **Draft Raporti: Fq. 10, paragrafi 1:** “Nga vizita në institucion dhe konkretisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u evidentua se kontratat e punës nuk përmbanin Disiplinën ku zhvillonte mësim stafi akademik PAE dhe PAK, CV jo të gjitha ishin të përditësuara dhe mungonte në një rast edhe fotokopja e kartonit

të Doktoraturës.

Përgjigja e IAL: Në kontratën e punës përcaktohet vetëm fakulteti dhe departamenti ku bën pjesë pedagogu, ndërsa lënda që jep ai është e përcaktuar në aneks kontratë që është pjesë përbërëse e kontratës. Kopja e kartonit të përmendur u vu në dispozicion menjëherë pas vizitës.

Përgjigja e GVJ: Përgjigja e IAL nuk shpjegon pasaktësitë e dosjeve. Është e saktë që na u tregua kopja e kartonit të Doktoraturës të përmendur, si rrjedhim GVJ do të shtojë në këtë paragraf faktin se kopja e kartonit të Doktoraturës na u tregua më vonë. **RVJ në këtë pjesë do të këtë ndryshim të pjesshëm.**

11. **Draft raporti: faqe 11, standarti 3.1:** “Në Zyrën e burimeve njerëzore na u komunikua se nuk kanë një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante pranë zyrës së Burimeve Njerëzore rekrutimi.

Përgjigja e IAL: “Konstatimi i GVJ është korrekt, por mund të shtohet se GVJ është sqaruar në takim me Zyrën e Burimeve Njerëzore se është duke impelmentuar një sistem të menaxhimit të universitetit dhe për pjesën e burimeve njerëzore po ndërtohet një modul i vecantë me të dhëna të detajuara për pedagogët me qëllim mbajtjen e një database të plotë. Nëpërmjet koordinatores së ASCAL në KUL iu vu në dispozicion GVJ komunikimi mbi kërkesat e detajuara të Burimeve Njerëzore për fushat e kërkuara. Gjithashtu në takim u sqaruan se info mbi historikun e publikimeve të vendeve vakante e mund të merret nga web i KUL, pasi aty ruhen të gjitha publikimet”.

Përgjigja e GVJ: Pas vizitës në Institucion IAL ka depozituar pranë ASCAL vetëm Rregulloren e zyrës së burimeve njerëzore. Është e saktë që gjatë vizitës na u komunikua se po ndërtohet një modul i vecantë me të dhëna të detajuara për pedagogët me qëllim mbajtjen e një database të plotë, por kjo i përket të ardhmes. GVJ i është përgjigjur Standartit 3.1 Kriteri 4 “Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.,” dhe në momentin e vizitës Institucioni nuk mbante bazë të këtyre të dhënave. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

12. **Draft Raporti: Faqe 12, Standarti III. 2:** “Institucioni duhet të respektojë në lidhje me Titullarët e lëndëve ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3“. Fq. 14, Konkluzionet e vlerësimit, pika 6: “Titullarët e lëndëve kanë të të paktën gradën shkencore “Doktor” ndërkohë që sipas kërkesave ligjore duhet të jenë të kategorisë Profesor. Institucioni duhet të respektojë në lidhje me Titullarët e lëndëve ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3”

Përgjigja e IAL: “Ligji ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3 përcakton se: „Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar“. Nga më sipër nuk rezulton detyrim që titullarët e lëndëve të jenë detyrimisht nga kategoria „Profesor“. Ndërsa pika 6 e këtij ligji sqaron se: „Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës“, gjë që mendojmë se nënkupton që titullarët e lëndëve në MP duhet të kenë së paku gradën Doktor”.

Përgjigja e GVJ: Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 6 i referohet Personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie, ndërsa në fq. 14, Konkluzionet e vlerësimit, pika 6, GVJ i referohet Titullarëve të lëndëve. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

13. **Draft Raporti: Faqe 12, Standarti III. 2:** „Mbikqyrja e praktikave profesionale me vendim Dekani bëhet nga një grup prej 5 pedagogësh. Në vendim është specifikuar se ky grup pedagogësh do të mbikëqyr praktikën mësimore për studentët e MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, studentët e MP në “Kontabilitet” dhe Studentët e MSH në Bankat dhe Tregjet financiare”. Nuk na u shpjegua se përse është ndjekur kjo formë mbikqyrjeje“.

Përgjigja e IAL: Kjo formë mbikqyrje është zgjedhur pasi numri i studentëve është relativisht i vogël në të tre këto programe.

Përgjigja e GVJ: Pas shqyrtimit të përgjigjes nga IAL, GVJ pranon komentin dhe do ta reflektojë në Raportin përfundimtar duke hequr frazën “Nuk na u shpjegua se përse është ndjekur kjo formë mbikqyrjeje”. **Ka ndryshim në RVJ.**

14. **Draft Raporti: Faqe 13, standarti 3.9:** “Në dosjet e pedagogëve u vunë re mangësi që vinin nga mos përditësimi i të dhënave”.

Përgjigja e IAL: Në raport mund të saktësohet se ka patur një rast ku për Dr. M. Duli, mungonte dokumenti i gradës shkencore, i cili u ne dispozicion menjëherë pas vizitës.

Përgjigja e GVJ: Ky rast do të shtohet në një nga ndryshimet e mësipërme (Fq. 10, paragrafi 1). Në këtë pjesë jepet nje konsideratë e përgjithshme. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

15. **Draft Raporti: faqe 18, Standarti II.9, paragrafi 2:** “Raporti i auditit për 2018 u kërkuar nga GVJ por nuk është në evidencat e dërguara nga institucioni më 05 Korrik 2019“.

Përgjigja e IAL: Sikurse u komunikua gjatë vizitës së GVJ, (04-05. 07.2019), afati ligjor i dorëzimit të raportit të auditit nga eksperti i pavarur, për vitin 2018, është dt. 31.07.2019. Ky raport aktualisht disponohet nga institucioni.

Përgjigja e GVJ: GVJ nuk pranon komentin sespe në Institucion nuk u dha si përgjigje data 31.07. 2019, por se raporti do të dërgohej pranë ASCAL nëse është dorëzuar pranë IAL. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

16. **Draft Raporti: faqe 19, pjesa përshkrimore, paragrafi 1:** “Në përfundim, Institucioni më 05 Korrik 2019 depozitoi në ASCAL dokumentat e kërkuara por në asnjë prej tyre nuk shprehet periudha e mandatit që kanë anëtarët e NJSBC”. Si edhe në faqe 23, tek konkluzionet e vlerësimit, pika 6: “GVJ edhe pas vizitës në institucion nuk ju dha evidencë për afatin e mandatit të anëtarëve të NJSBC, pavarësisht se theksoi që sigurimi i mandatit për anëtarët e NJSBC vlerësohet si shumë e rëndësishme për vijimësinë dhe mirëqeverisjen e njësisë për sigurimin e cilësisë në këtë institucion”.

Përgjigja e IAL: “Dëshiroj të theksojmë se as ligji i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, as udhëzimet në zbatim të tij nuk përcaktojnë se sa do të jetë afati i mandatit të anëtarit të NJSBC. Gjithashtu, po t'u referohemi standardeve dhe kriterëve edhe ato nuk e theksojnë këtë aspekt”.

Përgjigja e GVJ: “GVJ gjatë vizitës bëri me dije anëtarët e NJSBC për këtë gjetje e cila konsiderohet me rëndësi nga pikpamja e mirëqeverisjes (Corporate Governance) së IAL-së, me qëllim që anëtarët e NJSBC të kenë mbrojtje, siguri dhe vazhdimësi në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Kjo kërkesë vjen në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare lidhur me mirëqeverisjen e një institucioni. Gjatë vizitës nga përfaqësuesit e NJSBC u këmbëngul se afati i mandatit shprehej në statutin e KU Luarasi, por GVJ pas verifikimit nuk e evidentoi asnjë evidencë shtesë apo të shprehur në asnjë nen të statutit. Duke qenë se kjo vjen si standard nga praktikën më të mira, në përfundim të RVJ nuk do të vendoset tek rekomandimet për institucionin. **Nuk ka ndryshime në RVJ”.**

17. **Draft Raporti: faqe 19 pjesa përshkrimore, paragrafi 3:** “GVJ kërkoi evidenca të realizimit të këtyre detyrave dhe nëse e shikon të nevojshme ta rishikoj këtë Plan Strategjik gjatë këtyre viteve. Institucioni

më 05 Korrik 2019 depozitoi në ASCAL dokumentat e kërkuara dhe gjatë vizitës u shpreh se NJSBC është e vëmendshme të rishikoj Planin Strategjik kurdoherë që ka ndryshime matëriale të rrethanave të nevojshme për tu reflektuar”.

Përgjigja e IAL: “Dihet se Plani stradegjik përfshin periudhë kohore të caktuar afatgjatë, prandaj ai konsiderohet si i tillë. Kemi mendimin se ai nuk mund të rishikohet në cdo kohë ai na shërben si udhërrëfyes afatgjatë në realizimin e përvitshëm të objektivave të përcaktuara në të. Theksojmë se nuk ka asnjë kërkesë ligjore standard apo kriter që kërkon domosdoshmerisht rishikimin e planit stradegjik, aq më tepër kur vlerësohet vetëm një program studimi. Mendojmë se rishikimi i tij do të bëhej nqs do të kishim ndryshime thelbësore në ligj apo në aktet nënligjore. Aktualisht nuk jemi në një situatë të tillë emergjence për rishikimin e planit stradegjik. Natyrisht, në përfundim të periudhës të përfundimit kohor të planit stradegjik ekzistues do bëhet analiza dhe do të reflektohet për objektivat e peiudhës së ardhshme”.

Përgjigja e GVJ: Plani Strategjik është një prej dokumentave më të rëndësishëm dhe rishikimi i tij është i domosdoshëm kurdoherë që ka ndryshime matëriale të rrethanave të nevojshme për tu analizuar dhe reflektuar në objektivat dhe strategjitë që përmban plani strategjik. Këto janë standarde që mësohen në nivelin universitar pa qenë nevoja të kërkohen nga kuadri ligjor dhe rregullator. Nëse kjo nuk kuptohet që kërkohet atëherë pse GVB ka hartuar SWOT?! **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

18. Draft Raporti: faqe 20, paragrafi 2: “Analiza cilësore e të dhënave, mbi problemet që kanë rezultuar nga anketimet ose edhe se cilat kanë qenë hapat që institucioni ka planifikuar për të eliminuar shkaqet e problemeve, nuk pasqyrohen bazuar në evidenca të sakta në RVB e ofruar nga institucioni”.

Përgjigja e IAL: “Duhet të theksojmë se, nga anketimet që janë realizuar deri tani nuk ka dalë ndonjë problem shqetësues dhe si pasojë nuk e kemi parë të domosdoshme kryerjen e një analize të tillë”.

Përgjigja e GVJ: GVJ gjatë vizitës dhe takimit me studentët konstatoi rastin e një pedagogu për të cilin studentët gjatë vlerësimit të tyre për pedagogët ishin shprehur me rezerva për një prej tyre dhe institucioni në përfundim kishte marrë masa për këtë pedagog. Për të tilla raste por edhe raste të tjera që mund të shfaqen në të ardhmen Institucioni planifikon hapat për të eliminuar shkaqet e problemeve pa pritur që problemet të shfaqen dhe pastaj të mendosh si ti manaxhosh. Kërkohet një përqsje proaktive në parandalimin e problemeve sesa menaxhimin e pasojave. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

19. Draft Raporti: faqe 20, paragrafi 2: “Rishikimi i standardeve dhe procedurave të sigurimit të cilësisë për periudha të rregullta si dhe dorëzimi i tyre tek anëtarët e NJSBC dhe të Senatit për ndryshime të mundshme përbëjnë një praktikë të mirë drejt përmirësimit të cilësisë. Kjo është konfirmuar edhe përgjatë diskutimeve me drejtuesit e njësisve përkatëse”.

Përgjigja e IAL: “Standardet dhe kriteret nuk i përcaktojmë ne, aq më tepër t'i rishikojmë apo t'i ndryshojmë. Ato janë të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore. Ju lutem na sugjeroni, cilit standard, apo kriteri duhet t'i referohemi për ndryshimin apo rishikimin e tyre”.

Përgjigja e GVJ: Kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi jep minimumin e kërkesave për zbatim, ndërkohë që nga çdo IAL pritet shumë më tepër se kaq në përmirësimin e procedurave për sigurimin e cilësisë. Bazuar në analizat, kërkimet dhe studimet që ju kryeni duke konsideruar edhe profilin tuaj si institucion kërkohet të vendosen standard dhe kërkesa më shumë sesa vetëm ato të detyruara me ligj. Kërkohet një përqsje proaktive në parandalimin e problemeve sesa menaxhimin e pasojave. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

20. Draft Raporti: faqe 21, standardi I.10: “Në seksionin përkatës të RVB nuk reflektohet një analizë cilësore e rezultateve, si për shembull se çfarë problemesh janë evidentuar. Nuk ka asnjë lloj informacioni të paraqitur për përgjigjet apo rezultatet e arritura”.

Përgjigja e IAL: “Nga anketimet e studentëve deri më tani nuk kanë rezultuar vlerësime problematike për stafin akademik. Megjithatë, siç edhe e theksuam më lartë, KUL ka përpunuar të dhënat e përgjigjeve të pyetësorit të studentëve dhe ka bërë analiza krahasimore, (Evidenca 48 - Analiza e rezultateve të semestrit I-rë 2018 – 2019, 23 fq; Evidenca 44 -Analiza e vleresimit te mesimdhënies, 9 fq)”.

Përgjigja e GVJ: GVJ në pikën 14 më sipër sipas citimit të studentëve evidenton rastin e masave të marra nga institucioni pas rezultateve të vlerësimit të studentëve për një prej pedagogëve të FE. Pavarisht kësaj dhe vijimit të komentit të IAL-së për këtë fjalë në draft RVJ ku sillen disa evidenca, në përfundim GVJ i referohet RVB të depozituar pranë ASCAL dhe gjykon me vend të mos bëjë asnjë ndryshim. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

21. **Draft Raporti: faqe 24, paragrafi 5:** “Sipas RVB, Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 6 kategori lëndësh, nga A-ja deri tek F-ja. Në dokumentacionin e dërguar pas vizitës në institucion Plani mësimor është i ndarë sipas Veprimtarive Formuese nga A në E”

Përgjigja e IAL: “Tabela e korriguar e veprimtarive formuese me klasifikimin nga A - E, është dërguar me dokumentacionin plotësues dt. 05.07.2019 (formati excel)”.

Përgjigja e GVJ: Komenti pranohet por nuk ka ndryshim në Raportin përfundimtar sepse komentit thjesht pohon edhe një herë atë që ka thënë GVJ në raport. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

22. **Draft Raporti: faqe 29, konkluzionet e vlerësimit, pika 3:** “Nga analiza e syllabuseve vihet re se nuk ka lëndë, modul apo tema që trajton sistemet tatimore, politikat fiskale, kompanitë e sigurimit, fondet e investimeve dhe të pensioneve duke mos arritur kështu objektivat formuese të programit të studimit”.

Përgjigja e IAL: “Dëshirojmë të nënvizojmë se aplikimi i programit mësimor të paraqitur nga FE është miratura nga MASH, është bërë duke u konsultuar me specialistët e këtij programi, si dhe duke marrë vlerësimin nga eksperti i fushës Prof. Dr. H. Xhafa. Megjithatë duke marrë parasysh vlerësimin e RVJ dhe tendencave të tregut në të ardhmen parashikojmë të përfshijmë në planin mësimor lëndë mbi politikat fiskale dhe sistemet tatimore”.

Përgjigja e GVJ: Lëndët e sipërpërmendura janë në objektivat formuese të programit të studimit, objektiva të përcaktuara nga hartuesit e këtij programi studimi. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

23. **Draft Raporti: faqe 35-36:** “Në lidhje me aktivitetet e organizuara nga njësi: vetë stafi dhe drejtuesit ndiejnë nevojën e kërkimit në thellësi, më të orientuar drejt aktiviteteve të profilizuara shkencore të cilat mungojnë, apo një qasje më aktive ndaj përfshirjes së biznesit në këto veprimtari, si edhe nevojën për analiza të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, etj. Imazhi dhe emri i pranueshëm i institucionit nga partnerët në treg bëjnë të mundur dhe ofrojnë një bazë të qëndrueshme për mbështetjen nga projekte që forcojnë kërkimin, përmirësojnë mesimdhënien dhe i shërbejnë ekonomisë shqiptare”.

Përgjigja e IAL: “Gjatë takimit është saktësuar dhe informuar GVJ mbi situatën reale të aktiviteteve konkrete në kuadër të kërkimit shkencor për vitin akademik 2018-2019”. Në vijim citohen disa prej tyre”.

Përgjigja e GVJ: Institucioni gjatë vizitës na bëri me dije disa aktivitete të nivelit institucional por jo të njësisë bazë. Gjithashtu evidencat të cilat janë sjellë në komentin për këtë pikë të draft RVJ, nuk janë të cituara në RVB e depozituar në ASCAL i cili shërben si dokument zyrtar i shoqëruar me evidencat respektive në sistemin e ASCAL. Në përfundim, GVJ gjykon me vend ta evidentoj këtë si çështje në konkluzione me qëllim për tu pasë kujdes nga IAL në të ardhmen. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

24. **Draft Raporti: faqe 35-36:** “Rekomandohet përfshirje më e madhe cilësore dhe sasiore e studentëve në kërkim, jo vetëm me detyrat e tyre, projektet e kursit por me orientime dhe qasje më të forta drejt

bashkëbërjes së projekteve/detyrave me stafet akademike në shërbim të tregut, duke bërë të mundur në këtë mënyrë lidhjen e kërkimit me mësimin”.

Përgjigja e IAL: “Gjatë takimit është diskutuar dhe komentuar që: Studentët e Masterit Profesional e kanë më të vështirë përfshirjen në Kërkimin Shkencor për shkak se orientohen drejt pjesës Profesionale dhe vinë direkt në ndihmë të bizneseve jo drejtperdrejt nëpërmjet kërkimit shkencor por nëpërmjet ekspertizës profesionale që është nevojë shumë e madhe për tregun, në kërkesën e përgatitjes së profesionistëve të mirefilltë. Absolutisht është e pranueshme rekomandimi për studentet e Masterit Shkencor, në një përfshirje më të madhe cilësore dhe sasiore të tyre në kërkim duke lidhur më fort mesimdhënien dhe kërkimim shkencor nëpërmjet një mentorimi akoma dhe më të fuqishëm nga lektorët e tyre në fushat përkatëse të ekspertizës së tyre, bazuar dhe në shtyllat kryesore të kërkimit shkencor të Fakultetit Ekonomik”.

Përgjigja e GVJ: Studentët e MP janë studentë të ciklit të dytë të studimeve dhe nuk janë nxënës të shkollave të mesme profesionale por ndjekin një program akademik për të cilin ata kanë kapacitetet dhe nevojën për mbështetje nga institucioni dhe stafi akademik për përfshirje më e madhe cilësore dhe sasiore në projekte në shërbim të tregut. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

25. Draft Raporti: faqe 36: “Numri i projekteve kërkimore të fituara është 7 sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por ka mungesëtë të dhënave se cilat projekte kërkimore i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku”. Së fundmi, IAL është më i sukseshëm në tregun e projekteve, sepse ka ditur të kapërcejë pengesën ligjore, duke krijuar një OJF, e cila gëzon të drejtën e aplikimit. Universiteti ka intensifikuar përpjekjet për të marrë pjesë në projekte të financuara nga palë të treta dhe nga instrumentat e BE-së. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB”.

Përgjigja e IAL: “Saktësojmë që gjatë takimit në institucion, me zv. rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, GVJ-së nuk i është konfirmuar 7 projekte kërkimore të fituara. Projektet e fituara dhe zbatuara janë projekte gjithëpërfshirëse dhe jo në veçanti për Fakultetin Ekonomik. GVJ është informuar gjatë takimit për projektet e zbatuara me financim nga vetë Institucioni apo dhe projekte të aplikuar për financim nga donatorë të huaj për Fakultetin Ekonomik, të Drejtësisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, evidenca faktike nuk janë kërkuar për tu dorëzuar”.

Përgjigja e GVJ: GVJ gjatë vizitës në institucion ju bëri me dije se aktivitetet e raportuara ishin të nivelit institucional por jo të njësisë bazë, gjë e cila u konfirmua edhe nga institucioni. Edhe në komentet e dhëna për këtë pikë të draft RVJ, janë evidentuar disa projekte por pa shprehur se cilat i përkasin njësisë bazë. Pavarisht këtyre, GVJ në përfundim i referohet RVB të depozituar në ASCAL i cili shërben si dokument zyrtar i shoqëruar me evidencat respektive në sistemin e ASCAL. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

26. Draft Raporti: faqe 36: “KU Luarasi ka organizuar 10 aktivitete shkencore sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave se cilat aktivitete i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe cilat janë ato. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB”.

Përgjigja e IAL: “Saktësojmë që gjatë takimit në institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, GVJ është informuar për aktivitetet shkencore të realizuara si me poshtë:....”.

Përgjigja e GVJ: GVJ gjatë vizitës në institucion ju bëri me dije se aktivitetet e raportuara ishin të nivelit institucional por jo të njësisë bazë, gjë e cila u konfirmua edhe nga institucioni. Edhe në komentet e dhëna për këtë pikë të draft RVJ, janë evidentuar disa projekte por pa shprehur se cilat i përkasin njësisë bazë. Pavarisht këtyre, GVJ në përfundim i referohet RVB të depozituar në ASCAL i cili shërben si dokument zyrtar i shoqëruar me evidencat respektive në sistemin e ASCAL. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

27. Draft Raporti: faqe 36: “Më shumë se 50 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në këto aktivitete sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave se cilat aktivitete i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe cilat janë ato aktivitete. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.”

Përgjigja e IAL: “Informacioni i kërkuar është dërguar me evidencat plotësuese dt. 05.07.2019, ku është paraqitur në veçanti pjesmarrja e stafit akademik në Konferencën Shkencore “Integrated Policy on Research and Innovations” (Evidenca e punës shkencore te pedagoqeve -pdf), dhe pjesa më poshtë e informacionit është informuar gjatë takimit. Saktësojmë që gjatë takimit në institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënies me jashtë, GVJ është informuar për aktivitetet shkencore të realizuara si më poshtë si dhe pjesmarrja përkatëse e tyre: Projektet...”

Përgjigja e GVJ: GVJ gjatë vizitës në institucion ju bëri me dije se aktivitetet e raportuara ishin të nivelit institucional por jo të njësisë bazë, gjë e cila u konfirmua edhe nga institucioni. Në evidencën e dërguar në ASCAL në datë 05 Korrik 2019 u bë një saktësim i cili shërbeu për tu pasqyruar në konkluzionet e këtij standardi. Komentet e dhëna për këtë pikë të draft RVJ, janë disa projekte por pa shprehur se cilat i përkasin njësisë bazë duke vijuar në asimetrinë e RVB-së. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

28. Draft Raporti: faqe 37: “Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor 10 studentë kanë marrë pjesë në kërkimin shkencor sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave se sa studentë i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku”. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB”.

Përgjigja e IAL: “10 studentë kanë marrë pjesë në kërkimin shkencor, përfshirë të gjithë Fakultetet atë të Drejtësisë, Ekonomikut dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Asnjë student i Masterit Profesional “Financë dhe Menaxhim Risku”, nuk është bashkautor me një pedagog në këtë konferencë, ka vetëm bashkepunime në një paper por nuk është konkluduar në fund me emrin si bashkëautor në të”.

Përgjigja e GVJ: GVJ në përfundim i referohet RVB të depozituar në ASCAL i cili shërben si dokument zyrtar i shoqëruar me evidencat respektive në sistemin e ASCAL. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

29. Draft Raporti: faqe 37, standardi III.10: “Bazuar në Evidencën Nr. 49 dhe 50, evidentohen dy tranime të kryera për stafin akademik. Por GVJ nuk evidentoi evidencat të trajnimit të stafit akademik jashtë vendit. Gjatë vizitës në institucion u kërkua nëse njësia bazë ka informacion tjetër duhet ta vendos në dispozicion. Pyetjes se së GVJ se: A ofron institucioni mbështetje financiare për trajnimin jashtë vendit të stafit? Institucioni u përgjigj se: Nuk janë kryer por mendohet të ftohen disa ekspertë të huaj dhe të bëjnë trajnim këtu në vend”.

Përgjigja e IAL: Nje mundësi tjetër për stafin akademik janë pjesmarrja në Programin Erasmus+. Marreveshjet Erasmus+ ekzistuese dhe ato për Vitin e ardhshëm akademik paraqiten më poshtë...”

Përgjigja e GVJ: Komentet e sjella për këtë pikë të draft RVJ i përkasin të ardhmes së mundshme. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

30. **Draft Raporti: faqe 39:** “Aktualisht Fakulteti Ekonomik dhe vecanërisht pedagogët efektiv të këtij programi studimi nuk janë pjesë e projekteve Kombëtare apo ndërkombëtare”.

Përgjigja e IAL: Saktësojmë që gjatë takimit në institucion, me zv. rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënies me jashtë, GVJ është informuar si më poshtë:

1. Prof. Asoc. Dr Anni Dasho Sharko-angazhuar në një Projekt Ndërkombëtar të Komunitetit European si Senior Expert në Zhvillimin e Sistemit Kompjuterik të Akreditimit të Republikës së Kosovës.
2. Univerisiteti Luarasi ka aplikuar nëpërmjet Prof. Asoc. Dr Anni Dasho Sharko në një projekt CONS: “University Knowledge Transfer” i cili është në faze ri-aplikimi, ku janë present 13 shtete përfshirë dhe Shqipërinë me partner KU Luarasi.

Përgjigja e GVJ: Përshkrimi në Draft Raport i referohet Fakultetit Ekonomik dhe pedagogëve efektiv të këtij program studimi. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

31. **Draft Raporti: faqe 39:** “Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj KU “Luarasi” fton vazhdimisht lektorë të huaj dhe vendas që zhvillojnë leksione të hapura apo trajnime dhe në këto aktivitete marrin pjesë edhe pedagogët edhe studentët e këtij programi studimi. Në tabelën 19. Jepen 5 orë mësimi me lektorë të huaj. Pas kërkesës së dokumentacioneve nga GVJ institucioni ka ngarkuar dokumentin Aktivitete dhe leksione të hapura, por është një dokument që nuk evidenton nëse këto aktivitete janë zhvilluar në vitin akademik 2018-2019, dhe në disa raste pa specifikuar Lektorin përkatës.”

Përgjigja e IAL: Aktivitetet e raportuara janë zhvilluar në vitin akademik 2018 – 2019, konkretisht...”.

Përgjigja e GVJ: Draft Raporti është hartuar mbi bazën e RVB dhe dokumentacioneve të dorëzuara, megjithatë në Konkluzionet e këtij standarti nuk janë evidentuar paqartësitë në lidhje me Aktivitetet dhe leksionet e hapura. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

32. **Draft Raporti: faqe 39:** “Në tabelën 19 jepet se 1 student ka zhvilluar mobilitet por gjatë vizitës u informuam se KU “Luarasi” është pjesë e rrjetit ERASMUS por deri tani nuk ka pasur mobilitete pedagogësh apo studentësh”.

Përgjigja e IAL: Duhet saktësuar se në kuadër të programit i cili akreditohet nuk ka patur mobilitet. Ndërsa Institucioni është pjesë e ERASMUS dhe ka patur mobilitete të studentëve në nivelin Bachelor 3 studente të Fakultetit Ekonomi-Finance Banke për vitin akademik 2018 2019. Marveshjet Erasmus për Vitin tjetër Akademik dhe me pas të cilat janë lidhur që këtë vit akademik janë si më poshtë ...”.

Përgjigja e GVJ: Pas shqyrtimit të përgjigjes nga IAL, GVJ do të ndryshojë fjalinë e faqes 39, duke shtuar në fund “për këtë program studimi”. **Ka ndryshim në RVJ.**

33. **Draft Raporti: fq. 39. Vlerësimi i Treguesve të matshëm:** Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/jashtë vendit dhe prezantime. Asnjë pjesëmarrës në aktivitete shkencore jashtë IAL apo jashtë vendit.

Përgjigja e IAL: Saktësojmë që gjatë takimit në institucion, me zv.rektoren për kërkimin shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, GVJ është informuar si më poshtë:

1. Prof.asoc. Dr. Anni Dasho Sharko-angazhuar në një Projekt Ndërkombëtar të Komunitetit European si Senior në Zhvillimin e Sistemit Kompjuterik të Akreditimit të Republikës së Kosovës.
2. Prof.asoc. Dr. Stefan Qirici- angazhuar në mësimdhënie Maqedoni-Universiteti Europës Juglindore
3. Prof. asoc. Dr. Indrit Baholli-angazhuar në mësimdhënie Kosove: Iliria University.

Përgjigja e GVJ: GVJ ka hartuar RVJ bazuar në RVB, dokumentacion dhe takimi me stafin gjatë vizitës. Në lidhje me konstatimin sa më sipër GVJ është bazuar në të dhënat e RVB dhe konkretisht Tabela 19. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë tabelë Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/jashtë vendit dhe prezantime është lënë bosh që nënkupton 0. Në përgjigjen e IAL jepet informacion mbi Projekt dhe mesimdhënie dhe jo për pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë IAL apo jashtë vendit. GVJ do të vazhdojë të bazohet për këtë pikë në RVB. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Misioni i KU“Luarasi” është të pajis studentët me një edukim cilësor të qëndrueshëm; t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. Misioni është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, nëfushat që ushtron aktivitetin akademik, tëkontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, të integrojë mësimdhënien me kërkiminshkencor, etj..

Misioni i Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku” është ne përputhje me misionin e Institucionit. Misioni i MP në“Financë dhe Menaxhim Risku” është përgatitja e specialistëve dhe profesionistëve në fushën e Financës dhe Menaxhimit të Riskut të cilët do të japin kontributin e tyre në sektorin privat dhe organizma të ndryshme me fokus sektorin bankar.

Qëllimi i KU Luarasi është të ofrojë arsimim cilësor nëpërmjet dijeve tëqëndrueshme, kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Qëllimi i Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë “Master Profesional" "Financë dhe Menaxhim Risku” është ofrimi dhe formimi i studentëve me njohuri të avancuara teorike e praktike në fushën e financave dhe të menaxhimit të riskut, me anë të studimeve, praktikës dhe kryerjes së kërkimit shkencor.

Objektivat e programit “Master Profesional” në “Financë dhe Menaxhim Risku” janë në një linjë me misionin dhe qëllimin e programit. Kështu si objektiv është formimi profesional me anë të kualifikimit të nevojshëm. Objektiv i programit është pajisja e studentëve me njohuri teorike të fushës së financës si dhe formimi i ekspertëve edhe në aspektin praktik aplikativ në fushën e financës dhe menaxhimit të riskut.

Me anë të praktikave bashkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencës shqiptare në fushën e Financës dhe Menaxhimit të Riskut, vlerësimit të pasurisë, instrumentave të financës dhe menaxhimit të Riskut synohet të kompletohen njohuritë e studentëve dhe të jenë të aftë për tju pergjigjur nevojave të tregut për specialistë si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Me realizimin e programit të studimeve dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve këtij programi, studentët, si specialistë të finances do fitojnë disa kompetenca e cilësi si:

aftësi të avancuara për analizën e pasqyrave financiare në aspektin e riskut financiar, dije të thella profesionale për ushtrimin me kompetencë të detyrave dhe attributeve të financierit, për manaxhimin e fondeve financiare në kompani dhe institucione, në sistemet tatimore, njohjen e parimeve dhe operimit të programeve informatike në fushën e Financë dhe Menaxhim Riskut, etj.

KU “Luarasi” ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për institucionin për periudhën 2016 -2020. Strategjia e KU “Luarasi” është e mbështetur në misionin e institucionit. Në planin strategjik qëllimi është të ofrojë arsimim cilësor nëpërmjet dijeve të qëndrueshme, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Objektivat në funksion të qëllimit synojnë krijimin e profesionistëve, mbi cilësinë dhe performancën akademike, mbi kërkimin shkencor dhe inovacionin mbi partneritetet dhe rritjen e numrit të studentëve. Fokusi strategjik është mbi përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve

njerëzore dhe të kulturës së cilësisë. Do të përmirësohet jeta studentore do të përmirësohen dhe zgjerohen shërbimet mbështetëse akademike në mënyrë që të plotësohen nevojat me auditore cilësore, laboratore dhe biblioteka.

Zhvillimi strategjik i programit të studimit Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku” është konceptuar në kuadër të zhvillimit institucional të Kolegjit Universitar “Luarasi”, bazuar në strategjinë e tij të Zhvillimit Institucional.

Në planin afatshkurtër dhe afatgjatë, Kolegji Universitar “Luarasi” ka synuar dhe synon konsolidimin e Programit të studimit Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku”, për ta bërë të krahasueshëm me programet më të mira të kësaj fushe në vend e më gjerë. Ndërtimi i programit “Master Profesional” në “Financë dhe Menaxhim Risku” është orientuar nga nevojat e tregut të punës për profesionin e specialistit të financës dhe fushën e gjërë të punësimit. Ky program merr në konsideratë njohuritë e marra nga studentët në ciklin e parë të studimeve duke synuar në thellimin dhe aplikimin e tyre në praktik.

Objektivat formuese të programit të studimit Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku”, të përcaktuara në Rregulloren e MP “Financë dhe Menaxhim Risku”, janë formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në fushën e bankave, sigurimeve, dhe politikave të sistemeve fiskale. Pajisja e studentëve me njohuri themelore dhe bashkohore ndërkombëtare dhe eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit, bankave, bursave, shoqërive të sigurimit, fondeve speciale të investimeve apo pensioneve dhe institucioneve të sferës së politikave fiskale, tatimore dhe doganore, etj.

Institucioni ka hartuar Scientific Research Strategy 2019-2024, ku janë përcaktuar objektivat e qarta të kërkimit shkencor. Objektivi i Strategjisë së kërkimit shkencor është ngritja e KU Luarasi në nivele Lider në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit. Për të arritur këtë objektiv është mbështetja e kërkimit shkencor me burime nga KU Luarasi, rekrutimi dhe mbajtja e kërkuesve më të mirë në të gjitha nivelet e karrierës, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Misioni i Programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” është përgatitja e specialistëve dhe profesionistëve në fushën e Financës dhe Menaxhimit të Riskut të cilët do të japin kontributin e tyre në sektorin privat dhe organizma të ndryshme me fokus sektorin bankar. Ky mision përputhet me misionin e KU Luarasi, të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në fushat që ushtron aktivitetin akademik, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Objektivat formuese të programit të studimit Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku”, të përcaktuara në Rregulloren e MP “Financë dhe Menaxhim Risku”, janë formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në fushën e bankave, sigurimeve, dhe politikave të sistemeve fiskale, por ne syllabuset e programit të studimit nuk gjejmë syllabus apo module që të mundësojnë formimin e studentëve me njohuri nga fiskalitetet, sigurimet apo pensionet.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

	<p>Për hapjen e programit të studimit institucioni është bazuar në të dhëna dytësore nga Institucione si INSTAT duke vëzhguar trendin e përgjithshëm të të numrit të bizneseve në vend duke e pasur si bazë reference të tregut të punës.</p> <p>Institucioni ka marrë në konsideratë zhvillimin ekonomik të vendit që do të pasohet me rritje të bizneseve dhe të punësuarve në fushën e financës dhe menaxhimit të riskut.</p> <p>Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” bazohet në kërkesat e tregut për specialist në financë dhe menaxhim risku dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Studentët të cilët diplomohen në këtë program studimi mund tëpunësohen si në sektorin privat ashtu edhe publik.</p> <p>Ky program studimi pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është përshtatur me strategjinë e institucionit në drejtim të krijimit të profesionistëve në fushën e financës dhe menaxhimit të riskut.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> <p>Emërtimi i Programit “Master Profesional” në “Financë dhe Menaxhim Risku” është në përputhje të plotë me nivelin 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është program i ciklit të dytë të studimeve dhe pajis të diplomuarin me njohuri të thelluara, profesionale në fushën e Financës dhe Menaxhimit të Riskut. Studimet përmbillen me punim diplome dhe marrin diplomë “Master profesional” në “Financë dhe Menaxhim Risku”</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Institucioni KU “Luarasi” ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për institucionin për periudhën 2016 -2020 për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve.</p> <p>Pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit për institucionin për periudhën 2016 -2020 është edhe plani strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. 2. Ky program studimi është në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit. 3. Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është përshtatur me strategjinë e institucionit në drejtim të krijimit të profesionistëve por nuk përmbush objektivat formuese të kompletimit të studentëve me njohuri nga fiskalitetet, sigurimet apo fondet e investimeve dhe pensione. 	

4. Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënljore në fuqi.
5. Institucioni KU “Luarasi” ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për institucionin për periudhën 2016 - 2020 ku synohet zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të studimeve dhe përmirësimi i rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

KU Luarasi përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga 3 njësi kryesore, përkatësisht Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Përgjegjës për programin MP “Financë dhe Menaxhim Risku” është Fakulteti Ekonomik, njësi bazë e të cilit është Departamenti i Financës si pjesë e organigramës së KU Luarasi. Fakulteti Ekonomik është strukturuar nga tre njësi bazë, përkatësisht tre departamente dhe nga dy komisione të përhershme.

Nga analiza e RVB dhe dokumentave të depozituara në Dosjen e Vetvlerësimit (DVV) në sistemin e ASCAL, u evidentua nevoja për saktësim për Fakultetin Ekonomik nëse ka 9 PAE me grada shkencore (3 departamente x 3=9) apo 11 PAE. Ky Numër nuk ishte i njëjtë me numrin në Tabelën 1 dhe 2 të RVB. Gjithashtu nevojitej të saktësohej për Fakultetin Ekonomik nëse gradat për PAE dhe PAK sipas Tabelës 2 përputhen me të dhënat e depozituara në “Institution Profile” të KU “Luarasi” në ASCAL. GVJ gjatë vizitës në Institucion ju bëri me dije drejtuesve të Njësisë bazë dhe Njësisë kryesore, si dhe GVB se: RVB ka mospërputhje brenda vet raportit të identifikuar në disa tabela si konkretisht në Tabelat 1, 2, 4, 5, 6 dhe 6/2 të RVB dhe të krahasuara me të dhënat e evidencave si edhe atyre të depozituara në “Institution Profile” të KU Luarasi në ASCAL. Lidhur me këtë çështje u komunikua nga Institucioni se mospërputhjet ekzistojnë por janë bërë padashje (lapse) dhe GVB do të bëjë të gjitha rregullimet në format e raportimit për të pasqyruar me vërtetësi realitetin lidhur me gradat shkencore të PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti Ekonomik ka në strukturën organizative si autoritete drejtuese Dekanin dhe Drejtuesit e Departamenteve që janë njësitë bazë. Në FE të KU Luarasi janë 3 njësi bazë në funksion të programeve mësimore: 1. Departamenti i Financë- Bankë; 2. Departamenti i Administrim Biznesi; 3. Departamenti i Ekonomiksit. Fakulteti Ekonomik ka në organizimin e tij edhe organe kolegiale drejtuese të tilla si: Asambleja e personelit akademik të Fakultetit Ekonomik si edhe dy komisione të përhershme. GVJ gjatë vizitës ju bëri me dije GVB se RVB duhet të citonte me reference në këtë seksion të raportit evidencën ku përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e këtyre njësive.

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat,

Institucioni ka strukturë të integruar dhe të përbërë nga 3 njësi kryesore, përkatësisht Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. FE ka 3 njësi bazë në funksion të programeve mësimore: 1. Departamenti i Financë- Bankë; 2. Departamenti i Administrim Biznesi; 3. Departamenti i Ekonomiksit. Në vitin akademik 2018-2019, sipas RVB Fakulteti Ekonomik ka në përbërjen e tij 65 punonjës personel akademik efektiv dhe me kontratë si edhe personel administrativ, nga të cilët Personelit Akademik Efektiv (PAE) me kohë të plotë përbëhet nga 21 punonjës, ku secila njësi bazë ka në përbërjen e saj 7 punonjës efektive, ku të paktën tre punonjës mbajnë gradën shkencore. Numri i Personelit Akademik me Kontratë (PAK) me kohë të pjesshme është 38.

Mësimdhënia dhe veprimtaria shkencore e Fakultetit mbështetet nga 6 punonjës si staf administrativ. Njësia bazë për programin që po vlerësojmë është Departamenti i Financë- Bankë, pavarësisht se të tre njësitë e fakultetit koordinojnë aktivitetin mësimor dhe shkencor për programin e studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”.

Nga të dhënat në RVB u konstatuan pasaktësi në grada dhe tituj të stafit akademik. Nga vizita në institucion na u komunikua që janë lapsuse në RVB. Nga Institucioni u ridërguan të dhënat për personelin akademik PAE dhe PAK(tituj dhe grada). Ndryshimet nuk ndikojnë në përmbushjen e standarteve.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>KU Luarasi përfaqëson një IAL i cili përmes strukturave të tij kryen veprimtarin për të cilën është licencuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi si edhe statutin dhe planin e saj të zhvillimit strategjik.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion kërkoi sqarim dhe evidencë për plotësim nëse kjo njësi bazë ka objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar në dokumenta të miratuara zyrtarisht. Përgjigja nga drejtuesit ishte se kjo njësi do të sjelli evidencë për plotësimin e këtij kriteri i quajtur Plani Strategjik i FE. Në përfundim, nuk u depozitua asnjë dokument i tillë, e vërtetuar kjo në përgjigjen me dokumentin “Materiale shtesë të kërkuar nga GVJ” të depozituar pranë ASCAL në datë 05 Korrik 2019 nga KU Luarasi.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion bëri pyetje dhe mori përgjigje për angazhimin dhe njohjen e përgjegjësive të njësisë bazë për këtë program. Edhe gjatë takimeve të kryera në departamentin e burimeve njerëzore u konfirmua angazhimi i njësisë bazë gjatë procesit të rekrutimit të stafit akademik.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> Institucioni duhet të ketë kujdes të përcjellë informacion simetrik për atë çfarë kërkohet përmes kriterëve në saktësinë e të dhënave dhe informacion për Fakultetin Ekonomik dhe Departamenti i Financë- Bankë si njësia bazë që mbulon programin në vlerësim. GVJ gjatë vizitës në institucion jua bëri me dije dhe fakti të gjitha mospërputhjet e evidentuara në RVB dhe të krahasuara me të dhënat e evidencave si edhe atyre të depozituara në “Institution Profile” të KU Luarasi në ASCAL. Përfaqësuesit e institucionit u shprehën se do të bëjmë të gjitha rregullimet në format e raportimit për të pasqyruar me vërtetësi realitetin lidhur me gradat shkencore të PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program. RVB për kriterin 1 tek Standardin II.3 duhet të shprehej me fakte për përpjekjet që kanë bërë për rritjen e cilësisë së stafit akademik, pasi nuk gjenden në RVB elementë sasior apo cilësor që ta mbështesin këtë argument. Gjatë vizitës në institucion ju bë me dije kjo mangësi dhe përfaqësuesit e institucionit shprehën dakordësinë për mungesën e argumentave në RVB por u shprehën gjithashtu për ekzistencën e një dokumenti që vërteton përmirësimin e bërë prej institucionit dhe e depozituan pranë ASCAL në datë 05 Korrik 2019. Megjithatë, GVJ edhe pas konsultimit me këtë dokument konkludon se në FE dhe njësia bazë që mbulon programin në akreditim gjatë vitit të fundit akademik PAE me tituj dhe grada shkencore ishin shtuar vetëm me një PAE me gradë shkencore ndërsa të gjithë të punësuarit e tjerë ishin me Msc, si konkluzion nga njësia bazë duhet të ishte bërë më shumë përpjekje për rekrutim të PAE me grada shkencore dhe tituj. 	

3. Evidencat e vendosura në RVB duhet të ishin në përputhje me atë që kërkon Kriteri për çdo standard. P.sh per Standardi II.3, Kriteri 1 dhe Kriteri 2 në RVB kanë përkatësisht Evidencën 9 (përmban tabelat me të dhënat për PAE dhe PAK por jo atë çfarë kërkohet nga Kriteri 2) dhe Evidencën 20 (përmban kriteret për rekrutim të stafit por jo atë çfarë kërkohet nga Kriteri 2). Gjithashtu, në seksionin Dokumentacioni Përkatës është cituar edhe Evidenca nr. 11 mbi hapjen e programit dhe studimit të tregut duke mos e cituar për cilin kriter është sjellë kjo evidencë. Ndërkohë që evidenca nr.11 e depozituar në ASCAL nuk është studimi i tregut. Gjatë vizitës në institucion pasi GVJ ju bë me dije këto mangësi, përfaqësuesit e institucionit shprehën dakordësinë për pasaktësitë në RVB dhe u shprehën se studimi egziston në kuadër më të gjerë.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, ofrohet nga Departamenti Financë-Bankë. Personeli i Departamentit Financë-Bankë ka në përbërje personel akademik, personel ndihmës akademik dhe personel administrativ. Personeli akademik ndahet në personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Personeli akademik realizon veprimtarinë e mësimdhënies, këshillimin për studentët si dhe kërkimin shkencor. Personeli akademik efektiv përbëhet nga drejtuesit dhe stafi akademik i brendshëm të cilët përveç realizimit të mësimdhënies mund të kryejnë edhe detyra administrative. Personeli akademik me kontratë përbëhet nga lektorët e ftuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, Tabela 4.

Në programin e studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, janë angazhuar në mësimdhënie 13 pedagogë nga të cilët, 8 pedagogë të brendshëm dhe 5 pedagogë të jashtëm. Raportin numerik ndërmjet pedagogëve është 61.5 % të brendshëm dhe 38.5% të jashtëm. Ndërsa ngarkesa e orëve të mësimi zhvillohet në 70.8% të saj nga PAE dhe 29.2% nga PAK.

Ky program studimi është relativisht i ri dhe numri i studentëve është i ulët por me rritjen e numrit të studentëve numri i pedagogëve të brendshëm do të jetë i pamjaftueshëm.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (Anekse, tabela 3)

Këshilli Shkencor i programit të studimit është i përbërë nga 5 anëtarë. Koordinatorin e programit të studimit ka gradën Profesor i asociuar. Të gjithë anëtarët janë personel efektiv me tituj dhe grada shkencore. Në përbërje është 1 Profesor, 3 Profesor të asociuar dhe një pedagogë me gradën shkencore Doktor.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Anekse, tabela 4)

Pedagogët që japin mësim në këtë program studimi të nivelit të dytënë këtë vit akademik 2018-2019, janë në pjesën më të madhe me tituj dhe grada. Nga 8 pedagogë efektivë janë: 1 Prof Dr; 3 Prof. As; 2 Dr dhe 2 Msc duke përbërë 75% të personelit efektivë me tituj dhe/ose grada.

Ndërsa Lektorët e ftuar janë gjithsej 5 pedagogë nga të cilët 2 Prof. Dr; 1 Prof As; 1 Dr dhe 1 Msc, duke qenë kështu 80% me tituj dhe/ose grada.

Të dhënat sipas kualifikimeve dhe seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit (Anekse, Tabela 5, 6/1; 6/2) Pedagogët efektivë janë 8 dhe nga këta 7 prej tyre janë meshkuj, pra 87.5% janë meshkuj. Ndërsa pedagogët e ftuar janë në total 5: 3 femra dhe 2 meshkuj, 60 % janë femra. Gjithsej janë 13 pedagogë nga këta 9 meshkuj dhe 4 femra, 69% janë meshkuj.

Persa i përket moshës, 10 nga pedagogët efektivë dhe me kontratë janë të moshës 25-45, pra stafi ka një moshë relativisht të re, Tabela 6.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontrata e punës është mbështetur në Kodin e Punës, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e mardhënies të punësimit të punonjësve si dhe dokumentacionin bazë të institucionit si Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. Kontratat administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

Kontratat e punës lidhen ndërmjet institucionit të përfaqësuar nga Rektori dhe personeli akademik apo ndihmës akademik sipas rastit. Kjo kontratë nënshkruhet nga Rektori dhe i punësuarit sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe rregullores së institucionit. Kontrata e punës përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve. Stafi akademik që zotëron titull akademik dhe gradë shkencore kanë kontrata pune pa afat ndërsa personeli akademik pa tituj dhe grada kanë kontrata me afat një vjeçar. Nga vizita në institucion dhe konkretisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u evidentua se kontratat e punës nuk përmbanin Disiplinën ku zhvillonte mësim stafi akademik PAE dhe PAK, CV jo të gjitha ishin të përditësuara dhe mungonte në një rast edhe fotokopja e kartonit të Doktoraturës, e cila ju tregua GVJ ditën vijuese të vizitës.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Personeli ndihmës-akademik ndihmon mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me synim realizimin cilësor të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe ndihmon në zhvillimin e institucionit. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i bibliotekës dhe personeli mbështetës për IT.

Personeli administrativ kryen veprimtari administrative dhe teknike në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Stafit akademik për programin e studimit Master Profesional "Finance dhe Menaxhim Risku" për vitin akademik 2018-2019
- Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, (titujt/gradat)
- Ngarkesa totale e Stafit akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit realizojnë detyrat e tyre në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre në përputhje me Statutin dhe rregulloren e institucionit.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me Planin strategjik të zhvillimit për KU "LUARASI" 2016 - 2020. Personeli ndihmës akademik ndihmon personelin akademik gjatë realizimit të planit mësimor. Personeli akademik është përgjegjës për hartimin e kurrikulave, për zbatimin e tyre në procesin mësimor si edhe për veprimtari administrative kur ka nevojë institucioni.

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve personeli akademik ka rol aktiv dhe shumë të rëndësishëm.

Përgjegjësi i departamentit drejton punën për hartimin e kurrikulave për të gjitha ciklet e studimeve të lëndëve që mbulon departamenti, planeve mësimore dhe ndjek zbatimin e tyre

Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në përputhje me Rregulloren e Institucionit.

Kontrata e punes lidhet ndërmjet personelit akademik dhe Rektorit të KU Luarasi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Rektor miraton edhe ngarkesën mësimore vjetore ndërkohë që Dekani mbikqyr realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik. Përgjegjësi i departamentit specifikon nevojat dhe kriteret për rekrutimin e ri.

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren.

Në fund të vitit akademik përgjegjësi i departamentit evidenton mungesat dhe nevojat për staf për vitin pasardhës. Nëse rezulton se duhet të merret një staf i ri i drejtohet kërkesë Dekanit të Fakultetit i cili ja komunikon Rektorit. Ky i fundit miraton fillimin e procedurave për rekrutimin e ri, sikurse përcaktohet edhe në Statut dhe Rregullore të institucionit.

Në programin e studimit MP në "Financë dhe Menaxhim Risku", japin mësim 8 pedagogë të brendshëm dhe 5 pedagogë të jashtëm, ku personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, në aspektin numerik zë 61.5 % të personelit të angazhuar për realizimin e programit. Ky personel realizon 70.8% të orëve të programit.

Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Personeli akademik vlerësohet nga studentët nëpërmjet pyetësorit të zhvilluar online. Personeli akademik vlerësohet nëpërmjet pjesëmarrjes në orën e mësimin të drejtuesve.

Institucioni nuk mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante. Në Zyrën e burimeve njerëzore na u komunikua se nuk kanë një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, por kanë të dhëna mbi personelin PAE dhe PAK në vite, bazë kjo e krijuar nga kërkesat e Akreditimeve periodike nga Agjencia e Akreditimit ASCAL.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi (Kordinatori) i programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” ka titullin “Profesor i Asociuar”.</p> <p>Titullarët e lëndëve kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Institucioni duhet të respektojë në lidhje me Titullarët e lëndëve ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3.</p> <p>Pedagogët e tjerë kanë të paktën diplomën “Master i Shkencave” dhe janë të gjithë me përvojë në fushën ekonomike të financës dhe menaxhimit të riskut, si dhe të lëndëve që mbulojnë.</p> <p>Në KU “Luarasi, Rektori, zv/rektori, administrator i përgjithshëm dhe administratorët e fakulteteve, Dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Mbikqyrja e praktikave profesionale me vendim Dekani bëhet nga një grup prej 5 pedagogësh. Në vendim është specifikuar se ky grup pedagogësh do të mbikëqyr praktikën mësimore për studentët e MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, studentët e MP në “Kontabilitet” dhe Studentët e MSH në Bankat dhe Tregjet financiare”.</p>
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentët që ndjekin këtë program studimi e kanë të përcaktuar udhëheqësin për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve Evidenca 41.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni pedagogët ushëheqës kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Nga vizita na u komunikua se pedagogët udhëheqës nuk mbikëqyrin më shumë se 5 studentë.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Nga CV e stafit akademik evidentohet se fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Stafi akademik është një staf me përvojë profesionale në fushën e programit të studimit. Udhëheqësi i kërkimit shkencor ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Personeli ndihmës mësimor-shkencor angazhohet maksimalisht për realizimin e orëve laboratorike (laboratori i informatikës) dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore në KU “Luarasi. Studentët e këtij programi e përdorin laboratorin e vënë në dispozicion të tyre për punën e tyre të pavarur për punimet e kursit apo temën e diplomës. Ky program studimi nuk ka të parashikuar ore laboratorike. Institucioni dëshmon për përpjekje për përdorimin optimal të burimeve njerëzore për realizimin e objektivave të programit, kjo realizohet me përcaktimin e përgjegjësive të qarta për secilin në kontratat e punës.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe ne zbatim te rregullores se programit dhe institucionit. Ngarkesa mësimore përcaktohet që në fillim të vitit akademik. Nga tabela: “Ngarkesa totale e Stafit akademik”, rezulton se ngarkesa minimale e stafit akademik PAE e këtij programi në të gjitha programet që ofron ky institucion është 120 orë ndërsa ngarkesa maksimale është 190 orë. Ndërsa për stafin akademik PAK të këtij programi në të gjitha programet që ofron ky institucion është minimumi 20 orë mësimi dhe maksimumi 240 orë.</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. Stafit akademik efektiv realizon 340 orë, ndërsa stafi akademik me kontratë realizon 140 orë mësimore. Me përjashtim të një rasti pedagogët zhvillojnë mësim në një lëndë. Vetëm një pedagog zhvillon mësim në dy lëndë. Ngarkesa minimale per nje pedagog është 30 orë (nje lëndë) dhe maksimumi është 90 orë (dy lëndë).</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Në dosjet e pedagogëve u vunë re mangësi që vinin nga mos përditësimi i të dhënave.</p> <p>Ky program studimi është në vitin e tij të parë në formën e riorganizuar. Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.</p> <p>Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik, ndihmës mësitor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me Planin strategjik të zhvillimit për KU "LUARASI" 2016 -2020.
2. Kontrata e punës lidhet ndërmjet personelit akademik dhe Rektorit të KU Luarasi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Personeli akademik është përgjegjës për hartimin e kurrikulave por edhe zbatimin e tyre në procesin mësitor
4. Në programin e studimit Programi i studimit MP në "Financë dhe Menaxhim Risku", japin mësim 8 pedagogë të brendshëm dhe 5 pedagogë të jashtëm, ku personeli akademik i punësuar me kohë të plotë zë 61.5 % të personelit të angazhuar. Ky personel realizon 70.8% të orëve të programit.
5. Personeli akademik vlerësohet nga studentët nëpërmjet pyetësorit të zhvilluar online. Personeli akademik vlerësohet nëpërmjet pjesëmarrjes në orën e mësimit të drejtuesve.
6. Titullarët e lëndëve kanë të paktën gradën shkencore "Doktor" ndërkohë që sipas kërkesave ligjore duhet të jenë të kategorisë Profesor. Institucioni duhet të respektojë në lidhje me Titullarët e lëndëve ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 59, pika 3.
7. Staf i akademik është një staf me përvojë profesionale në fushën e programit të studimit.
8. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Kjo bazë të dhënash ka nevojë të përditësohet.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

KU Luarasi i kushton vëmendje infrastrukturës dhe rolit të tij në rritjen e cilësisë të programeve mësimore. GVJ konsideron si vend shumë të përshtatshëm godinën e institucionit ku kryhet veprimtaria akademike tek Rruga e Elbasanit, ku ndodhen disa godina Universitare.

Infrastruktura e institucionit dëshmon jo vetëm seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e administrimit të KU Luarasi, por edhe funksionalitetin e saj në shërbim të cilësisë së programeve. KU Luarasi paraqitet i kompletuar me salla leksioni, seminare, konferenca, laboratore si edhe me të gjitha paisjet e nevojshme teknike dhe didaktike, me një mobilim të përshtatshëm.

Infrastruktura ndihmëse (furnizimi me energji elektrike, uji, ngrohja) janë në funksion të veprimtarisë së këtij programi studimi, të komoditetit të studentëve dhe personelit akademik.

Siç paraqitet në tabelën 7 të RVB, Aneks, KU Luarasi iu përmbahet normave të hapësirës së përdorshme, me një raport prej 5.15 deri në 12.4 m² për student.

GVJ gjatë vizitës në Institucion përmes pyetjeve dhe komunikimit me studentët dhe stafin akademik evidentoi se nuk kishte akses pa kufizim në internet. Gjithashtu, GVJ gjatë vizitës në Institucion evidentoi se: biblioteka e KU Luarasi siguron një ambient të qetë, të përshtatshëm dhe të rehatshëm për lexuesin, infrastrukturë teknike për zhvillimin dhe përdorimin e burimeve online për kërkim shkencor, burime informacioni për studentët dhe stafin akademik.

Studentët mund të shfrytëzojnë për qëllimet kërkimore edhe baza të të dhënave dhe burime nga biblioteka online “Questia”. Gjatë takimit të GVJ me studentët u shprehën se nuk e kemi përdorë dhe nuk na kanë trajnuar për përdorim të bibliotekës online “Questia”, ata ishin në dijeni që ekzistonte edhe kjo lloj biblioteke në institucion.

Gjithashtu KU Luarasi kishte të vendosur në funksion të veprimtarisë edhe sekretarit mësimore, ku një prej tyre ishte e dedikuar për MP Financë dhe Menaxhim Risku.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

GVJ konstaton se situata e infrastrukturës e paraqitur dhe e përshkruar në RVB përputhet me situatën reale, të konstatuar gjatë vizitës në institucion.

GVJ gjykon që Infrastruktura në përgjithësi, është një nga përparësitë e KU Luarasi. Jo vetëm infrastruktura akademike, por edhe ambientet rekreative janë të përshtatshme për të mbështetur cilësinë e punës kërkimore dhe garantuar mirëqenien dhe shëndetin e studentëve dhe stafit akademik. Institucioni e ka trajtuar me shumë vëmendje çështjen e infrastrukturës. Gjatë takimit të GVJ me studentët dhe stafin akademik u konstatua se ata i vlerësojnë si të përshtatshme ambientet dhe infrastrukturën e institucionit për kryerjen normale të veprimtarisë së MP “Financë dhe Menaxhim Risku”. Këto opinione si edhe ilustron nga tabela 7 forcojnë bindjen e GVJ – së se KU Luarasi ka investuar me seriozitet në funksion të ndërtimit të një infrastrukture që ti shërbejë mësimdhënies korrekte në këtë institucion.

GVJ në takimet me përfaqësuesit e studentëve evidentoi problemin e vështirësive për parkim pasi nuk kishte vend parkimi as për ata dhe as për stafin akademik, ndonëse institucioni është përpjekur që të ofrojë zgjidhje kur ka pasë kërkesa nga njësia bazë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>GVJ mbështetur tek të dhënat e siguruar nga RVB si edhe nga vizita në institucion konstaton se institucioni zotëron një kontratë qeraje të lidhur në datë 29.06.2013 për 20 vite sipas Evidencës Nr. 24, për të vetmen ndërtesë ku zhvillohet veprimtaria mësimore dhe administrative lidhur me programin MP. Kjo ndërtesë ka ambientet e mjaftueshme për kryerjen e kësaj veprimtarie të shoqëruar me infrastrukturën e nevojshme. Objekti është rikonstruktuar në përpjekje për të realizuar një proces mësimor sa më cilësor.</p> <p>Sa i takon praktikave profesionale gjatë vizitës GVJ kërkoi evidenca nëse KU Luarasi ka akomoduar kërkesa të studentëve për të zhvilluar praktikën në veprimtari të ndryshme pranë subjekteve të grupit Hysenbelliu si edhe në institucionet dhe kompanitë me të cilat KU Luarasi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ mbështetur tek të dhënat e siguruar nga RVB si edhe nga vizita në institucion konstaton se institucioni, në përpjekje për të realizuar një proces mësimor sa më cilësor, ju siguron studentëve akses tek literaturë e zgjedhur, bashkëkohore dhe në sasi të mjaftueshme. Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme nëpërmjet bibliotekës, e cila disponon literaturë cilësore dhe të pasur, kryesisht në gjuhë të huaj, në fushën e shkencave ekonomike, tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse.</p> <p>Biblioteka e KU Luarasi është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka mjaftueshëm vende leximi dhe paisje teknologjike, për të garantuar punën akademike dhe kërkimin shkencor të studentëve. GVJ gjatë vizitës me qëllim plotësimin kriterit 1 dhe 4 kërkoi: Kur ka qenë përditësimi më i fundit i bibliotekës? Sa tituj? Me çfarë shkresash është kryer kjo? Përgjigje nga Shefi departamentit ishte se do të depozitohet një evidencë të blerjeve të fundit. Në përfundim, nuk u depozitua asnjë dokument i tillë e vërtetuar kjo me dokumentin “Matëriale shtesë të kërkuar nga GVJ” të depozituar pranë ASCAL në datë 05 Korrik 2019 nga KU Luarasi, pavarësisht se gjatë vizitës në bibliotekë evidentuam në raftet por edhe në dokumentat e inventarit literaturën e blerë së fundmi nga institucioni.</p> <p>Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkua nga pedagogët dhe studentët përmes aksesit në bibliotekën online “Questia” por sipas vizitës në vend studentët nuk kanë marrë një trajnim si mund ta përdorin atë.</p> <p>Biblioteka ka orare (8.30- 17.00) të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve, mësimi i këtij masteri fillon në orën 16.00 ndërkohë që biblioteka mbyllet në 17.00 dhe studentët kanë mundësi të marrin literaturën e kërkuar.</p> <p>Në RVB është paraqitur orari 8.30-20.00 por gjatë vizitës në institucion na u sqarua se Biblioteka mbyllet në orën 17.00 por studentët mund të vazhdojnë të studiojnë në sallën e leximit.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion vërejtë se: KU Luarasi ka krijuar një strukturë logjistike të vlerësueshme për punën e pedagogëve dhe të studentëve në ambientet e tij. Fakulteti Ekonomik për MP “Financë dhe Menaxhim Risku” ka aktualisht në përdorim 1 sallë leksioni dhe 2 salla seminari (ndërkohë që në faqen 30 të RVB thuhet se për këtë program janë në dispozicion 3 salla leksioni dhe salla seminaresh. Gjatë vizitës në institucion u pohua prej tyre se institucioni për këtë program ka në dispozicion 1 sallë leksioni dhe 2 salla seminaresh por institucioni mund t’ju vendos në dispozicion edhe salla të tjera nëse është e nevojshme. Të gjitha sallat janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore në KU Luarasi janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e</p>

programit. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Në përputhje dhe zbatim të metodologjisë së vlerësimit, GVJ konsideron se KU Luarasi ka krijuar logjistikë funksionale dhe mjedise pune të përshtatshme si për pedagogët dhe studentët. Kjo pasqyrohet në të gjitha drejtimet e infrastrukturës si dhe evidentohet qartazi nga treguesit e matshëm.
2. GVJ gjithashtu konstaton se mirëqenia e stafit akademik dhe e studentëve është gjithashtu e konsideruar si aspekt i veçantë. Çështja e parkimit, e konsideruar si kritike për përfaqësuesit e studentëve dhe stafit akademik është zgjidhur pjesërisht në mënyrën më efektive të mundshme.
3. Fondi bibliotekës pasurohet në mënyrë të vazhdueshme sipas RVB (Evidenca 42, 46 dhe 47), por këto nuk përmbajnë të dhëna për buxhetin financiar dhe përditësimin e tyre. RVB duhet të plotësonte evidencat për këtë argument dhe seksion. Dokumentimi u kërkua gjatë vizitës dhe drejtuesi njësisë bazë u shpreh se do të depozitonte një evidencë të blerjeve të fundit. Në përfundim, evidenca nuk u depozitua, por gjatë vizitës në bibliotekë evidentuam vetë në raftet dhe në dokumentat e inventarit disa tituj për literaturën e blerë së fundmi nga institucioni.
4. GVJ gjatë vizitës në institucion kërkoi ti paraqiten evidenca për: Ku ruhen dhe si është e organizuar ruajtja e të dhënave (rregjistrim, matriculim, vlerësime, etj) të studentëve të këtij programi? Përgjigjia dhe evidencat e marra ishin për ruajtjen me shumë kujdes në rregjistra fizikë si edhe në sisteme të thjeshta për ruajtjen e tyre.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

KU "Luarasi" i siguron burimet financiare kryesisht nga Tarifata e studimeve prej studentëve si dhe nga tarifata e shërbimeve administrative për studentët, nga kurset dhe trajnime. Institucioni ndërton Raportin financiar (pasqyrat financiare) për çdo vit, komform legjislacionit në fuqi. Pasqyrat financiare auditohen nga Audituesit i pavarur. Nga Pasqyrat financiare Raportin financiar 2018, evidenca 22, si dhe Raporti i Audituesit të pavarur 2017, evidenca 23, institucioni ka kapacitete financiare për mbarëvajtjen e aktivitetit. Të ardhurat janë në rritje nga viti në vit si rrjedhojë e rritjes së numrit të studentëve, të specifikuar edhe tek Raporti Vjetor i Kolegjit Universitar "Luarasi" viti akademik 2017 -2018. Pjesa më e madhe shpenzimeve shkojnë për pagesat e pedagogëve. (Aneks, tabela 8)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifata për dhe gjatë shkollimit 97%
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet sigurose, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
- Të ardhura të tjera nga veprimtaria 3%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet për studentët janë të ndryshme si kosto e punës, shpenzimet për ambiente, për infrastrukturën didaktike, etj. Në masën më të madhë shpenzimet për studentët i zënë pagat e personelit akademik, me rreth 70%, Tarifa e shkollimit në KU “Luarasi”, miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të KU “Luarasi”. Kosto e studimit për student për vit akademik llogaritur si raport i shpenzimeve për vit akademik dhe numrin e studentëve paraqitet për vitin akademik 2018- 2019 është 1071 Euro (e dhënë kjo e marrë nga RVB).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Pasqyrat financiare auditohen nga Auditues i pavarur. Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Raporti i auditit përshkruan se përmban një pasqyrë të qartë (pasqyrat financiare bashkelidhur) për të ardhurat e kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë. Nuk ka të ardhura nga grantet.</p> <p>Nga dokumentacionet e dorëzuara në posedojmë Evidencën 22. Raportin financiar 2018. Raporti i auditit jep opinionin se Pasqyrat Financiare paraqesin drejt aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin 2017. Raporti i auditit për 2018 u kërkua nga GVJ por nuk është në evidencat e dërguara nga institucioni më 05 Korrik 2019.</p> <p>Raporti i Auditimit raporton se Pasqyrat financiare paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parasë të shoqërisë KU “Luarasi”.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton Pasqyrat financiare për cdo vit kalendarik dhe në to pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve. Në RVB është paraqitur një tabelë ku janë treguar kostot, dhe edhe kosto për student.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen, bazuar kjo në Pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditimit.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ndërton Pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pasqyrat financiare auditohen nga një Auditues i pavarur.
2. Nga të dhënat nga Pasqyrat financiare 2018 dhe Raporti i Audituesit të pavarur 2017 institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare kjo e ardhur nga rritja e numrit të studentëve, të ardhurat e të cilëve janë burimi kryesor i financimeve.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ, mbështetur në RVB por edhe gjatë takimeve në IAL me NJSBC, vëren se: Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion bëhej i mundur përmes ngritjes dhe vënies në funksionim të disa mekanizmave si:

- Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë i cili është institucionalizuar si strukturë organizative në KU Luarasi nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të strukturave të përhershme. Një dokument bazë i përdorur nga kjo njësi është Manuali për Sigurimin e Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga 5 anëtarë, Tabela 9. Këta anëtarë janë në këtë detyrë që nga 23/12/2016 për dy vite sipas Tabelës 9 në faqe 34 të RVB. GVJ gjatë vizitës kërkoi evidencë për propozimin dhe miratimin e anëtarëve të NJSBC dhe evidencë për afatin e mandatit i cili është shumë i rëndësishëm për vijimësinë dhe qeverisjen e kësaj njësie. NJSBC u shpreh se afati mandatit gjendet në Nenin 74 të Statutit të KU Luarasi, por në fakt kjo nuk gjendej e shprehur në këtë nen të statutit. Pas kësaj NJSBC u shpreh se do ta gjej dokumentin respektiv dhe do të na e vendosë në dispozicion. Në përfundim, Institucioni më 05 Korrik 2019 depozitoi në ASCAL dokumentat e kërkuara por në asnjë prej tyre nuk shprehet periodha e mandatit që kanë anëtarët e NJSBC.

- NJSBC siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë. NJSBC zgjidhet nga Senati Akademik siç parashikohet në Statutin e KU Luarasi. NJSBC është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike dhe mbështetëse të studentëve që garantojnë përputhshmërinë me kuadrin ligjor duke siguruar një përmirësim të cilësisë së vazhdueshme në KU Luarasi.

Bazuar edhe në takimet me drejtuesit e njësive të sigurimit të cilësisë por edhe me drejtues të njësive bazë dhe të fakultetit përkatës, GVJ konstatoi se Institucioni për të dhënë vëmendjen e duhur ngritjes së standardeve të cilësisë bazohet në disa dokumenta strategjike si: Plani Strategjik i NJSBC 2016-2020, i cili është i organizuar kryesisht si plan pune. GVJ kërkoi evidenca të realizimit të këtyre detyrave dhe nëse e shikon të nevojshme ta rishikoj këtë Plan Strategjik gjatë këtyre viteve. Institucioni më 05 Korrik 2019 depozitoi në ASCAL dokumentat e kërkuara dhe gjatë vizitës u shpreh se NJSBC është e vëmendshme të rishikoj Planin Strategjik kurdoherë që ka ndryshime matëriale të rrethanave të nevojshme për tu reflektuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Lidhur me informacionin për anketimet nga studentët për vlerësimin e pedagogëve dhe programit të studimit janë përfshirë 7 studentë gjatë vitit akademik 2018-2019, ndërkohë që numri i vlerësimeve është 34. Gjatë vizitës në institucion u kërkua shpjegim për tabelën në faqe 41 të RVB që shpreh se janë 34 vlerësime nga 7 studentë. Përgjigja nga NJSBC ishte se ky është numri i të anketuarve për të gjitha lëndët. Sipas RVB ky proces koordinohet nga NJSBC dhe njoftohet Rektori si edhe pedagogu respektiv.

Analiza cilësore e të dhënave, mbi problemet që kanë rezultuar nga anketimet ose edhe se cilat kanë qenë hapat që institucioni ka planifikuar për të eliminuar shkaqet e problemeve, nuk pasqyrohen bazuar në evidenca të sakta në RVB e ofruar nga institucioni.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Nga takimet në institucione me drejtues të njësisë së sigurimit të cilësisë, por edhe me drejtues të njësisë bazë (departament dhe fakultet), si dhe drejtuesi i ekipit të raportit të RVB kanë siguruar se strategjitë, planet kërkimore, objektivat që kanë departamentet si njësi, dhe ato individuale, si dhe analiza në fund të vitit janë disa tregues që konfirmojnë mbështetjen e vazhduar në standardet e cilësisë.

Nga vizita në institucion, diskutimet me drejtuesit e njësisë bazë dhe dokumentacioni rezultoi se sfidat me të cilat përballet ky institucion, që kanë të bëjnë jo vetëm me krijimin dhe ruajtjen e standardeve, por edhe me zhvillimin e qëndrueshëm të këtij programi, kërkojnë nevojën e një platforme të re, të gjerë dhe ndërvepruese të sigurimit dhe ruajtjes së cilësisë. Përveç sa ka kryer, NJSBC duhet të sigurojë transparencën e plotë ndaj pretendentëve dhe sidomos përmes publikimit të raporteve.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

GVJ konstaton se KU Luarasi investon në rritjen e cilësisë, gjë e cila demonstron nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe kontrollit të cilësisë, nëpërmjet monitorimit të aktivitetit akademik dhe mësimdhënies të personelit akademik. Në këtë kontekst, si vlerësimet e studentëve, ashtu edhe të kolegëve, shërbejnë për të nxjerrë përfundime që kanë të bëjnë me ecurinë e përgjithshme të programit si edhe të procesit të mësimdhënies.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Përgjegjësitë e Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë janë të rrisin dhe zhvillojnë sistemin e garantimit të Cilësisë në përputhje me misionin dhe kërkesat kombëtare të institucionit. Anëtarët e NJSBC dhe Koordinatorit i Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit që mbulon Programin janë përgjegjës për çështjet e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Bazuar në të dhënat nga dosja e vetëvlerësimit, gjendja në institucion synon të përafrojë sa më shumë drejt standardeve cilësore dhe imazhit që KU Luarasi ka në tregun e arsimit të lartë. Rishikimi i standardeve dhe procedurave të sigurimit të cilësisë për periudha të rregullta si dhe dorëzimi i tyre tek anëtarët e NJSBC dhe të Senatit për ndryshime të mundshme përbëjnë një praktikë të mirë drejt përmirësimit të cilësisë. Kjo është konfirmuar edhe përgjatë diskutimeve me drejtuesit e njësisë përkatëse.

Evidentojmë se nga gjendja e konstatuar sipas evidencave të depozituara në database të ASCAL të krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues ka shumë ndryshime të dukshme dhe mos përputhje për evidencat e cituara konkretisht Evidenca 38 i cili pretendohet se është Raporti Vjetor ndërkohë që është një dokument që ka marrëveshjet e KU Luarasi me Universitete të tjera; Evidenca 36 i cili pretendohet se është për akreditimin e institucional të KU Luarasi ndërkohë që është një dokument me programin e konferencës Luarasi; etj.

Evidentojmë se nga gjëndja e konstatuar në Institucion gjatë vizitës krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues nuk ka ndryshime të dukshme, por ka vend për përmirësime, si psh përfshirjen e stafit në kërkim dhe përdorimin e kësaj si tregues të cilësisë në mësimdhënie; përfshirjen e Alumni në procesin e kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetje në më shumë projekte që synojnë përmirësimin e cilësisë së strukturave të sigurimit të cilësisë, ndarjen e eksperiencave me institucionet si motra brenda dhe veçanërisht jashtë vendit, organizimin e eventeve dhe tryezave të rrumbullakëta me institucione të tjera të arsimit të lartë apo kërkimore/politikbërëse për çështje të tilla, etj
Këto përmirësime do të mund të mbështesin në të ardhmen një riorganizim të mirë orientuar të programit përkatës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Institucioni bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në takimet dyditore me grupet e ndryshme, rezulton se ka një qasje pozitive drejt cilësisë. Për këtë synon të përafrojë me metodologji vlerësimi apo synon drejt përdorimit të instrumentave dhe treguesve matës.</p> <p>Nga takimet në institucion me drejtues të njësive së sigurimit të cilësisë, por edhe me drejtues të njësive bazë (departament dhe fakultet), si dhe nga takimi me stafin u konfirmua se përdorimi i vetëvlerësimeve, i kthyer tashmë në një proces të përvitshëm, është konsideruar si instrumenti kryesor i cili siguron një informacion të plotë mbi atë çka perceptojnë dhe gjykojnë studentët. Megjithatë, nga vetë drejtuesit apo studentët është konsideruar nevoja për më shumë raporte apo të dhëna sasiore apo dokumentacion për vlerësimin e pedagogëve.</p> <p>Nga raportimi për Kriteri 3 të Standardit I.10, rezulton se NJSBC të dhënat i bën të ditur Rektorit dhe pedagogut respektiv, ndër aspektet që do të përmirësonte këtë proces është menaxhimi i të dhënave të anketimeve nga një numër më i madh stafi deri në nivelin e njësive bazë, me qëllim që një proces kaq delikat të mos menaxhohet në mënyrë individuale.</p> <p>Në seksionin përkatës të RVB nuk reflektohet një analizë cilësore e rezultateve, si për shembull se çfarë problemesh janë evidentuar. Nuk ka asnjë lloj informacioni të paraqitur për përgjigjet apo rezultatet e arritura.</p> <p>Të tjera metoda vlerësimi të konstatuara jo vetëm nga dokumentacioni por edhe në terren konfirmohen: vlerësimet e studentëve për kursin, vlerësimet e kolegëve për njëri tjetrin, formën e vlerësimit të performancës individuale të profesorëve, raportet vjetore të mësimdhënies, të nxëniet dhe standardet përkatëse të cilësisë të përpiluara nga departamenti në fund të vitit akademik.</p>

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Evidenca 38 e cituar në RVB dhe vendosur në databasë të ASCAL i cili pretendohet se është Raporti Vjetor i KU Luarasi për vetvlerësimin e brendshëm të veprimtarisë akademike, shkencore, etj., ku shprehen edhe rekomandimet për të ardhmen, por ndërkohë që është një dokument që ka marrëveshjet e KU Luarasi me Universitete të tjera dhe nuk është evidencë për atë që citohet nga GVB. Nuk gjenden evidenca të publikimit të rregullt të broshurave, buletineve, etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm si edhemi të gjitha konstatimi për mungesë të publikimit të prezantimeve në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm të KU Luarasi. GVJ gjatë vizitës evidentoi këtë mangësi.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

RVB shpreh se dekanati dhe departamenti përgjegjës do të bëjnë analizën vjetore pasi të përfundoj viti akademik 2018-2019, si rrjedhim RVB nuk përmban evidencë për këtë kriter.

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Nga diskutimet dhe informacionet e marra në institucion, si dhe nga raportet e vëna në dispozicion, vihet re një ndërgjegjësim jo vetëm i stafit akademik, studentëve, por në të gjitha nivelet jo vetëm ato drejtuese. Ndërgjegjësimi drejt cilësisë përbën një standard cilësor të dukshëm dhe të rëndësishëm. KU Luarasi përbën IAL të akredituar institucionalisht me Vendimin Nr.115, në datë 15.12.2017 për 6 vite deri në datë 14.12.2023.

Për të arritur këto nivele, por jo vetëm për këtë arsye, KU Luarasi përdor instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë si psh Manuali i Sigurimit të Cilësisë që është instrument institucional bazë për Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit.

KU Luarasi përdor mekanizmat formale për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve studimore, siç janë rishikimi i planit mësimor nga kreu i departamenteve, në bazë të zhvillimeve të institucionit, kërkesave ligjore dhe nevojave të tregut. Gjithashtu aplikohet edhe një mekanizëm rishikimi periodik të kurrikulës i cili miratohet nga Senati.

Instrumenta të tjerë që janë përdorur janë: vlerësimet e studentëve, liria drejt përdorimit të peticioneve, vlerësimet e pedagogëve nga supervizorët. Nga takimi me studentët rezultoi se jo gjithnjë ata janë të përfshirë në të gjitha hallkat dhe se do të dëshironin të ishin më aktivë dhe të kishin më shumë informacion. Kjo do të bënte të mundur sigurimin e cilësisë në hallka të ndryshme të vendimarrjes.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në takimet dyditore me grupet e ndryshme, rezulton se ka një qasje pozitive drejt cilësisë. Për këtë qëllim, institucioni synon të përafrojë me metodologji vlerësimi apo synon drejt përdorimit të instrumentave dhe treguesve matës.
2. Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë, janë institucionalizuar në dokumentat dhe politikat e institucionit, ndërsa nevojitet që të gjithë pretendentët të jenë të informuar. Për të mbështetur sfidat me të cilat përballlet ky institucion, që kanë të bëjnë jo vetëm me krijimin dhe mbajtjen e standarteve, por edhe me përballimin e sfidave që do të ndesh kjo veprimtari në të ardhmen, rekomandojmë që NJSBC të vijojë me rishikimin e Planit Strategjik duke e plotësuar përmes konsultimit me të gjithë pretendentët kryesor.
3. Nuk evidentohet publikimi i Raportit Vjetor të KU Luarasi për vetvlerësimin e brendshëm të veprimtarisë akademike, shkencore, me qëllim plotësimin e standardeve të kërkuara për publikimin rregullisht të informacionit të paanshëm, objektiv, sasior dhe cilësor të shoqëruar me tregues konkretë për matjen e këtyre treguesve.
4. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të NJSBC i sigurimit të rritjes dhe cilësisë (2016-2020) me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
5. Për vlerësimin e ecurisë së programit të studimeve MP “Financë dhe Menaxhim Risku” Institucioni ka detyrimin të hartojë politika që synojnë përmirësimin e programit të studimit dhe kjo e fundit nuk mund të lihet “me gjykimin sipas rastit” siç është shkruar nga vlerësimi i brendshëm për këtë kriter.
6. GVJ edhe pas vizitës në institucion nuk ju dha evidencë për afatin e mandatit të anëtarëve të NJSBC, pavarësisht se theksoi që siguri i mandatit për anëtarët e NJSBC vlerësohet si shumë e rëndësishme për vijimësinë dhe mirëqeverisjen e njësisë për sigurimin e cilësisë në këtë institucion.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni i këtij programi studimi është në përputhje me misionin e KU “Luarasi”, tju ofrojë studentëve një edukim cilësor dhe t’i shërbejë dije së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës.

Objektivat formues të Programit të studimit të ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Financë dhe Menaxhim Risku” është formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësor si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e bankave, sigurimeve dhe sistemeve fiskale. Pajisja e studentëve me njohuri themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit dhe menaxhimit të bankave, bursave, shoqërive të sigurimit, fondeve specifike të investimeve apo pensioneve, institucione dhe struktura të specializuara në sferën e politikave fiskale, tatimore e doganore, etj. Në objektivat formuese është edhe njohja dhe menaxhimi i suksesshëm i bankave, shoqërive të sigurimit, tregjeve financiare, etj. Fitimi i kompetencave të orientuara në fushën e instrumenteve të politikave monetare, kontabilitetit bankar, analizës së riskut, analizë dhe menaxhim i buxhetit qendror dhe lokal, politikave fiskale, etj..

Organizimi i programit është strukturuar në disiplina të formimit të përgjithshëm; disiplina karakterizuese të profesionit; lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, disiplina plotësuese si dhe detyrimet përmbyllëse.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është hapur fillimisht në bazë të Urdhërit Nr. 483, datë 12.10.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Ky program u licensua si master profesional me kohë të plotë, me 90 kredite dhe kohëzgjatje 1.5 vite akademike dhe është akredituar me Vendim Nr. 149, datë 31.03.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Në përputhje me këtë vendim dhe përshtatje me Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni u kërkua riorganizimi i programit në Master Profesional me 60 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 1 vit, kërkesë e cila është miratuar nga MASR me shkresën Nr. 5912/1, dt 13.09.2018.

Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit të riorganizuar MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është të përgatisë specialistë të fushës në Financë dhe Menaxhim Risku. Ky program studimi ka për qëllim të formojë profesionistët e rinj, të cilët do të kenë një formim teorik dhe praktik për të menaxhuar financat, menaxhuar riskun dhe analizuar aspektin financiar të raporteve ekonomiko –financiare të firmave apo institucioneve të veçanta, analizuar dhe menaxhuar sistemet e taksave, tregjet financiare, etj..

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Ky program studimi ka kohëzgjatje një vjeçare dhe me kohë të plotë. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore, i ndarë në dy semestra. Semestri akademik zgjat 15 javë mësimore. Çdo ditë mund të zhvillohen deri në 4 orë mësimi. Studenti zhvillon jo më shumë se 20 orë mësimore/javë, në auditor. Gjuha e programit është shqip. Ora e mësimit është 50 minuta me pushime 10 minutëshe ndërmjet orëve. Në semestrin e parë janë zhvilluar 5 lëndë dhe mësimi është zhvilluar cdo ditë nga e hena në te premte, në orarin 16.00-20.00. Në semestrin e dytë janë zhvilluar 3 lëndë dhe mësimi është zhvilluar në të njëjtin orar në tre ditë të javës. Gjatë semestrit të dytë janë zhvilluar edhe praktika profesionale dhe është punuar për Temën e diplomës.

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 10, Aneks).

Programi i studimeve MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, është program studimesh të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite (ECTS).

Gjatë vitit të fundit të studimeve, studenti mund të përgatisë një punim apo temën e diplomës, për të cilën edhe vlerësohet për punën e bërë. Disiplinat mësimore, veprimtaritë dhe detyrimet e tjera akademike vlerësohen me kredite (ECTS).

Programi i studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku” është program me kohëzgjatje normale një vjeçare dhe në fund të tij fitohen 60 kredite.

Sipas RVB, Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 6 kategori lëndësh, nga A-ja deri tek F-ja. Në dokumentacionin e dërguar pas vizitës në institucion Plani mësimor është i ndarë sipas Veprimtarive Formuese nga A në E.

- Veprimtaria Lëndë Bazë ka 6 kredite (ECTS) ose zë 10% të programit të studimit.
- Lëndë karakterizuese janë në total 21 kredite (ECTS) ose zënë 35% të programit të studimit.
- Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese kanë në total 15 kredite (ECTS) ose zënë 25% të programit të studimit.
- Lëndë Plotësuese është Praktike dhe Zhvillim Karriere dhe ka në total 6 kredite (ECTS) 10% të programit të studimit.
- Detyrime Përmbyllëse është Tema e Diplomes e cila ka 12 kredite (ECTS) ose 20% të programit të studimit.

Ndarja e Planit mësimor në Veprimtari Formuese nga A në E dhe ndarja e veprimtarive formuese në përqindje është komform legjislacionit në fuqi (VKM 41, datë 25.01.2018).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Programi i studimit MP në "Financë dhe Menaxhim Risku", realizohet nëpërmjet mësimi në auditor me anë të leksioneve, seminare, ushtrime. Gjithashtu nëpërmjet studimit të pavarur të studentëve shumë të nevojshëm për kërkimin shkencor. Në përgjithësi seminarët zënë 10% të vlerësimit, detyrat e kursit apo projektet zënë rreth 10%. Në përgjithësi ka një provim gjatë vitit me rreth 20 pikë dhe në fund provimi zë përgjithësisht 60% të vlerësimit. Në përmbyllje të programit të studimit realizohen edhe praktika profesionale dhe Tema e diplomës. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit.

Në tërësinë e orëve të planit mësimor (1500 orë), 480 orë, ose 32%, janë orë mësimi akademike në auditor, 180 orë në auditor janë për zhvillimin e Praktikës mësimore dhe Diplomës, që zënë 12% të totalit të orëve, ndërsa 840orë, 56 % e totalit të orëve, i përkasin studimit të pavarur dhe individual jashtë auditorëve. Përcaktim dhe ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë përcaktohet nga personeli akademik përgjegjës për disiplinën, në bazë të krediteve që i janë caktuar asaj discipline.

▪ Për leksionet	240 orë në auditor dhe 282 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminarët	240 orë në auditor dhe 288 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Laboratorët	N/A orë në auditor dhe N/A orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën lëndore	N/A orë në auditor dhe N/A orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	60 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur e studentit
▪ Teme Diplome	120 orë në auditor dhe 180 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks) Tabela 11.

Gjatë viti akademik 2018-2019 ka pasur vetëm një ndryshim në planin mësimor. Lënda Kontabiliteti Nacional është zëvendësuar me lëndën Kontabilitet Drejtimi.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotësoni Tabelën ne Aneks) Tabela 13.

GVJ pas njohjes me planin mësimor, stafin akademik përkatës dhe CV (si edhe nga kontrolli rastësor i disa prej dosjeve të personelit pranë Drejtorisë së BNj gjatë vizitës në Institucion) konstaton se formimi profesional i pedagogëve që japin mësim në lëndët e këtij programi studimi përputhet mjaftueshëm me lëndët që ata japin mësim. Të gjithë pedagogët që rezultojnë si të tillë nga plani mësimor janë realisht të angazhuar në mësimdhënie me ngarkesë nga 20 deri në 60 orë secili në këtë program studimi.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve

- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Ndërtimi i Syllabuseve është në përputhje me VKM 41, datë 25.01.2018. Syllabuset kanë të përcaktuar emërtimin e lëndës, kreditet që fiton studenti nga lënda, semestrin dhe vitin akademik kur zhvillohet lënda. Syllabuset përcaktojnë vendin që zë lënda në formimin e përgjithshëm, temat që do të trajtojnë lënda, ngarkesa në orë në auditorë dhe jashtë auditorit, format dhe metodat e mësimdhënies si dhe të vlerësimit të studentit, cdo syllabus përcakton detyrimet e studentëve dhe literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e programit të studimit mbulojnë fushën e Financës (Institucione Financiare dhe Tregjet e Kapitaleve, Analiza dhe Raporte Financiare, Strategjia e Korporatave Financiare, Banking), por vihet re se nuk ka lëndë, modul apo tema që trajton sistemet tatimore, politikat fiskale, etj. të cilat janë në objektivat formuese të programit të studimit. Ndërkohë që për Menaxhimin e Riskut është vetëm lënda Menaxhim Risku Financiar. Nuk ka lëndë, modul apo tema që trajtojnë kompanitë e sigurimit, kur sigurimi është një nga mënyrat kryesore të menaxhimit të riskut, ndërkohë që sigurimet janë edhe në objektivat formuese të programit. Nuk ka lëndë, modul apo tema që mbulojnë Fondet e pensioneve që është edhe në objektivat e formimit të programit të studimit.

Gjatë analizës së syllabuseve u vu re se Ngarkesa në orë jashtë auditorit e paraqitur tek Syllabuset nuk është e njëjtë me ngarkesën në orë jashtë auditorit që është dhënë në planin mësimor.

Në përgjithësi syllabuset kanë ruajtur të njëjtën strukturë ku në pjesën e parë jepen të dhënat e përgjithshme në lidhje me pedagogët e lëndës, ngarkesa, semestri, tipologjia, lloji i lëndës, kodi i lëndës. Në vijim jepet një Përmbledhje dhe qëllimet e kursit, Konceptet themelore celës, Temat e kursit, Format e kontrollit të vlerësimit, Literatura e detyrueshme dhe literatura e rekomandueshme (ndihmëse). Nga syllabuset vihet re se temat që përmban syllabusi në disa raste zërthehen në nënëshetje në disa raste jepen vetëm temat.

Nga GVJ është konstatuar se 6 nga 8 lëndët e programi të studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” janë të njëjta me 6 nga 8 lëndët e programi të studimit MP në “Kontabilitet”, kjo gjë u konstatua sepse një nga ekspertët e GVJ është i njëjtë për të dy programet e studimit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)
 - Syllabus Praktika MP në Kontabilitet
 - Praktikat Mesimore Kontabilitet
 - Udheheqje Dipllova Kontabilitet

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Ky program u licensua si Master Profesional me kohë të plotë, me 90 kredite dhe kohëzgjatje 1.5 vite akademike dhe është akredituar me Vendim Nr. 149, datë 31.03.2016 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit. Nga institucioni u kërkua riorganizimi i programit në Master Profesional me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 1 (një) vit akademik. Pas riorganizimit ky program studimi është në vitin e parë të funksionimit.
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	

	<p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” me kohë të plotë është 60 kredite ECTS.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të plotë profesional për specialistë Finance dhe Menaxhim risku.</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qarta profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor por trajnim jo të plotë profesional për specialistë Finance dhe Menaxhim risku.</p> <p>Në programin e studimit nuk ka lëndë, modul apo tema që trajton sistemet tatimore, politikat fiskale, etj., nuk ka lëndë, modul apo tema që trajtojnë kompanitë e sigurimit, apo fondet e pensioneve që janë objektivat e formimit të programit të studimit.</p> <p>MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” synon të zgjerojë dhe kompletojë njohuritë e studentëve të fituara në ciklin e parë të studimeve me koncepte teorike dhe praktike në fushën e financës dhe menaxhimit të riskut.</p> <p>Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij.</p> <p>MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” ka objektiva të qarta formimi të ekspertëve dhe specialistëve cilësor si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e bankave, sigurimeve dhe sistemeve fiskale.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar Rregullore për MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, ku janë përcaktuar qarta Objektivat formuese të këtij programi studimit. Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bëhet nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm me anë të testeve dhe provimeve përfundimtare dhe rezultatet dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion Drejtuesit deklaruan se për ndërtimin e programit mësimor kanë ndjekur praktika ndërkombëtare.</p> <p>Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për</p>

	arsimin e lartë dhe në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit.
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” është program studimi i ciklit të dytë dhe përfshin aftësimin profesional. Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me profilin e KU “LUARASI” dhe strategjinë e tij për zhvillim.</p> <p>Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve.</p> <p>Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Institucioni për hartimin e Programit të studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ka analizuar nevojat e tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” synon të plotësojë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase si bankat apo kompani private.</p>
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” ka marrë parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Institucioni nuk ka një studim tregu të mirëfilltë por ka bërë Analizë mbi hapjen e programit dhe studimin e tregut, ku thekson se: “Përprojektit treguan se për shkak të kufizimeve të të dhënave, është e vështirë të bëhet një analizë e plotë sasiore dhe cilësore e kërkesës dhe ofertës në tregun e profesionit “Financë dhe Menaxhim Risku” si një treg mjaft heterogjen dhe i gjerë”.</p> <p>Nga vizita në institucion na u komunikua që kanë marrë si bazë të dhënat e INSTAT në lidhje me rritjen e ekonomisë, numrit të bizneseve si dhe kërkesat e përgjithshme të studentëve për studime.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” realizohet me 60 kredite europiane ECTS dhe kohëzgjatje 1 vit akademik.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p>Informacioni për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët.</p>
<p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Që në fillim të vitit studentët njihen me syllabuset dhe temat që ato do të trajtojnë. Sërisht në fillim të çdo semestri prezantohet në auditor syllabusi.</p>
<p>Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p>Në planin mësimor është përcaktuar se në përfundim të vitit akademik studentët përmbyllin vitin me mbrojtje të Diplomës.</p>
<p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” ofrohet me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 1 (një) vit akademik. 2. MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” synon të zgjerojë dhe kompletojë njohuritë e studentëve të fituara në ciklin e parë të studimeve me koncepte teorike dhe praktikë në fushën e financës dhe menaxhimit të riskut dhe përfshin aftësimin profesional. 3. Nga analiza e syllabuseve vihet re se nuk ka lëndë, modul apo tema që trajton sistemet tatimore, politikat fiskale, kompanitë e sigurimit, fondet e investimeve dhe të pensioneve duke mos arritur kështu objektivat formuese të programit të studimit. 4. Ngarkesa në orë jashtë auditorit e paraqitur tek Syllabuset nuk është e njëjtë me ngarkesën në orë jashtë auditorit që është dhënë në planin mësimor. 5. Vlerësimi i studentëve bëhet nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm. 6. Institucioni për hapjen e programit të studimit ka marrë si bazë të dhënat e INSTAT në lidhje me rritjen e ekonomisë, numrit të bizneseve si dhe kërkesat e studentëve për studime, nuk ka bërë studim tregu të mirëfilltë. 7. Informacioni për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët 	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

GVJ konstaton se KU Luarasi trajton me përparësi sigurimin e standardeve të larta të mësimdhënies nëpërmjet harmonizimit të komponentëve teorikë dhe praktikë. Konstatohet se KU Luarasi nxit dhe mbështet forma inovative të mësimdhënies, në qendër të të cilave është studenti. Kjo pasqyrohet në radhë të parë në lirinë krijuese të stafit akademik, në funksion të rritjes së efektivitetit të mësimdhënies.

GVJ konsideron mjaft efikase praktikën e ndjekur nga stafi akademik të organizimit të procesit mësimor në mënyrë pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse, e cila ndihmohet edhe nga kombinimi i përshtatshëm ndërmjet orëve të leksionit dhe të seminareve. Në funksion të mësimdhënies cilësore është edhe literatura e gjerë dhe e larmishme që studentët mund të disponojnë si nëpërmjet teksteve kryesore ashtu edhe atyre ndihmëse.

Si në çdo institucion akademik, ndjekja e rregullt e programit mësimor është e detyrueshme, me një nivel pjesëmarrje përkatësisht prej jo më pak se 75% të orëve të mësimit. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se në procesverbalet e vlerësimit të studentëve nuk cilësohej në mënyrë specifike statusi i studentit (nuk ka frekuentuar, nuk kualifikohet, apo nuk u paraqit). Në procesverbale shënohej vetëm NP – Nuk u paraqit, pavarësisht nëse studenti nuk kishte frekuentuar fare lëndën, nuk kualifikohet të hynte në provim, psh, për mungesë prezantimi të detyrave të kursit, apo thjesht nuk ishte paraqitur në provimin përfundimtar.

Megjithatë, GVJ konsideron matjen e pjesëmarrjes të pamjaftueshme për të vlerësuar Cilësinë e të Nxënimit. Për këtë qëllim, GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe nga shpjegimet e stafit akademik, arriti në përfundimin se cilësia e të nxënimit monitorohet dhe vlerësohet me metoda përkatëse gjatë çdo seance, moduli dhe në fund të çdo lënde.

Nga vizita në institucion, diskutimet me drejtuesit e njëjësive bazë, stafin akademik, por veçanërisht edhe me studentët rezultoi se ka hapësira për të rritur mundësitë e përfitimit nga mësimdhënia.

Bazuar edhe në opinionet e stafit dhe studentëve, literatura në gjuhën shqipe përbën një pikë të dobët, sikurse nuk është e mjaftueshme për studentët e këtij programi krahasuar me atë të gjuhës angleze që kanë në dispozicion të tyre një larmishmëri titujsh nga biblioteka online dhe hard copy në bibliotekën e institucionit.

Rezultoi nga takimi me stafin por edhe drejtues të tjerë të institucionit se ngarkesa e pedagogëve për një vit akademik është diku rreth 220 orë në vit (nga evidencat e dorëzuara pas vizitës në institucion ngarkesa maksimale e stafit akademik PAE të angazhuar në këtë program studimi është maksimalisht 190 orë dhe e stafit akademik PAK është maksimalisht 240 orë). E gjitha kjo sigurisht që mund të çënojë cilësinë e mësimdhënies, vështirëson profilizimin e pedagogëve. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies ka një vlerësim online nga studentët për pedagogët, gjë e cila mbështet përmirësimin e procesit të mësimdhënies në FE. Ka përpjekje për të vendosur në qendër studentin dhe për ta përfshirë sa më shumë. Një formë është këshillimi akademik, nëpërmjet të cilit studentët përfshihen/aktivizohen në komponentët e aktivitetit të njësisë, ose përfshirja në forma të këshillimit të specializuar për mënyrën e kryerjes së obligimeve studentore. GVJ pyeti nëse ka qendra mbështetëse për aktivitetin e mësimdhënies dhe u konfirmua gjatë vizitës në institucion se kanë në përdorim laboratorësh dhe takime në bibliotekë, të cilat janë gjithashtu forma të nxitjes së aktivizimit. Institucioni u shpreh gjithashtu se po punon për ndërtimin e një database online për ruajtjen e të dhënave dhe update të të dhënave për çdo pedagog dhe student.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

GVJ gjykon që KU Luarasi përdor larmishmëri formash të mësimdhënies, me qëllim që të garantojë cilësinë më të mirë të mundshme si edhe efektivitetin e mësimdhënies. Leksionet dhe seminarët janë praktikë e zakonshme. Gjatë leksioneve dhe seminareve, përçimi i mesazheve ilustron nëpërmjet ushtrimeve dhe atje ku aplikohet përdorimi i laboratoreve. Në Tabelën 14 të RVB rezultoi të mos ketë asnjë orë në auditor për diplomën dhe praktikën profesionale si formë mësimdhënie në këtë program studimi por ndërkohë që në Planin Mësimor Tabela nr. 10 të RVB rezultoi që këto të kenë orë në auditor.

Format e kontrollit të njohurive

Pavarësisht ndryshimeve ndërmjet lëndëve të ndryshme sipas Tabelës 15 në RVB, vlerësimi bazohet tek pjesëmarrja, kontrolli i njohurive në mes të semestrit dhe në përfundim të tij, si edhe nëpërmjet hartimit dhe

realizimit të një detyre ose projekti kërkimor dhe duke i lënë provimit final 60% të peshës totale të vlerësimit për lëndën.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Bazuar edhe në Tabelën 16 të RVB konstatojmë se kërkohet nga institucioni të nxisë dhe mbështesë studentët për më shumë internshipe, një përfshirje më aktive e tyre në aktivitete si psh aktivitetet të BSH-së, konferenca shkencore studentore të AMF-së apo konferenca të IAL-së dhe më shumë raste studimi konkrete nga biznese shqiptare ku të analizohen histori suksesi apo dështimi, me qëllim që mësimdhënia të nxisë edhe elementët aktivë dhe inovativ tek studentët.

Gjatë takimit me studentët, ata mbështesin idenë se kanë nevojë për më shumë internshipe, apo aktivitete që nxisin përgatitjen e tyre jo vetëm teorike, apo duan të jenë më të përfshirë në diskutimet dhe mbledhjet periodike të njësisë bazë. Por këto ndryshime nuk ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Masteri Profesional në "Financë dhe Menaxhim Risku" është në vitin e parë të funksionimit të tij sepse ky program studimi është riorganizuar me Vendim Senati Nr. 18, datë 12.03.2018, i cili riorganizohet me 60 kredite me kohëzgjatje 1 vit akademik. Ky vendim Senati është miratuar nga MASR nëpërmjet shkresës Nr. 5912/1 prot, datë 13.09.2018.

Në këtë program studimi janë regjistruar 9 studentë por kanë frekuentuar 7 studentë. Nuk ka studentë të transferuar. Në fillim kanë marrënumrin e matrikulimit 6 studentënga Ministria Arsimit Sportit dhe Rinisë, por në kohën që u zhvillua vizita në institucion ishin marrë numrat e matrikulimit për të gjithë studentët.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve bazohen në Ligjin nr. 80/2015, Statutin dhe Rregulloren e KU "Luarasi", si edhe Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Financë dhe Menaxhim Risku". Dokumentaci i kërkuar është sipas Udhëzimeve të Ministrisë MASR si dhe kritereve të pranimit të përcaktuara nga institucioni.

Në këtë program studimi pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë dhe të huaj. Kriteret e pranimit në këtë program studimi janë:

1. Përfundimi i shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
2. Përfundimi i ciklit të parë, Bachelor në Ekonomi me programe të ngjashme.
3. Njohuritë formuese të aplikantëve duhet të konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve (jo më pak se 80 kredite).
4. Aplikanti duhet të zotërojë dëshmi të gjuhës angleze ose japin provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve, Niveli B1.

Theksojmë që ky kriter i fundit nuk përputhet me kërkesat e ligjeve në fuqi për Masterat Profesionalë.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës. (Evidenca 10)

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Janë rregjistruar 9 studentë, kanë frekuentuar 7 studentë dhe mesatarja në hyrje e studentëve është 5.9. viti akademik ende nuk ka përfunduar dhe nuk është llogaritur ende mesatarja në dalje e studentëve.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare. Tabela 17

Janë rregjistruar 9 studentë, nota mesatare 5.9.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Viti akademik nuk ka përfunduar dhe ende nuk është mbrojtur në Departament Tema e diplomës nga studentët. Nga takimi me studentët na u tha se jo të gjithë do të diplomoheshin në sezonin e Korrikut, por për shkak të angazhimeve të punës do të përfundonin temën dhe do ta mbronin në sezonin e vjeshtës.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

KU "Luarasi" pranon për të ndjekur studimet universitare, edhe studentët që vërtetojnë me dokumente zyrtare, konform legjislacionit në fuqi, transferimin nga një institucion tjetër i arsimit të lartë publik ose privat. Në programin Masterit Profesional në "Financë dhe Menaxhim Risku" në vitin aktual nuk ka patur studentë të transferuar nga Institucionet e tjera të arsimit të lartë.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Ky është viti i parë që ky Master është aktiv, megjithatë MP "Financë dhe Menaxhim Risku" me 90 kredite dhe afat 1.5 vite është hapur në vitin akademik 2012 – 2013 dhe është Akredituar me Urdhër Nr. 471, datë 19.09.2016. Zyra e Karrierës, ka mbajtur kontakte te vazhdueshme me studentet e diplomuar ALUMNI dhe sipas të dhënave në RVB pjesa më e madhe janë të punësuar. Ndërsa studentët aktual të programit të studimit nje pjesë e mirë e tyre janë aktualisht të punësuar dhe pjesa tjetër po pret të punësohet edhe nëpërmjet ndihmës së stafit akademik dhe Zyrës së karrierës. Megjithatë punësimi i studentëve mbetet për tu parë në vitet në vijim.

Numri total të diplomuarve

Nuk është diplomuar ende brezi i parë i studentëve.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nuk është diplomuar ende brezi i parë i studentëve, kjo mbetet të shihet në vitet e ardhshme.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nuk është diplomuar ende brezi i parë i studentëve, kjo mbetet të shihet në vitet e ardhshme.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Praktikant mësimore FinMenRisku. Në këtë evidencë jepen personat mbikeqyrës në vendin e praktikës.
- Plani vjetor i punës për departamentin e Karrierës, viti akademik 2018-2019.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimit në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, kanë kriter pranimit që duhet zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni. (Evidenca 10)</p> <p>Studentët e këtij programi e kanë kriter që duhet të zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze ose japin provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve, Niveli B1. Ky program studimi është në vitin e parë. Në vizitën në institucion u njoftuar se do të vlerësoheshin kriteret dhe politikën e pranimit për vitet pasardhëse.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të programit të studimeve dhe institucioni angazhohej maksimalisht për të ndihmuar studentët në gjetjen e vendeve të punës.</p> <p>Studentët janë njoftuar për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion. K. U “Luarasi” ka marrë akreditimin institucional për 6 vite nga viti 2017 deri në vitin 2023. (Evidenca 6)</p> <p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nga Zyra e karrierës.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimit deri në diplomim.</p>	<p>Ky program studimi është në vitin e parë të funksionimit si program i riorganizuar. Institucioni disponon statistika në lidhje me të diplomuarit në MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” në periudhën ku ka qenë me 90 kredite. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. Në këtë program studimi një student është larguar dhe një tjetër nuk ka frekuentuar. Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimit deri në diplomim.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë, por studentët e këtij programi nuk janë diplomuar ende.</p> <p>Statistikat e mbajtura janë në lidhje me studentët e regjistruar në këtë program studimi, cilësinë e tyre në hyrje dhe numrin e studentëve që kanë frekuentuar semestrin e parë si edhe rezultatet e tyre në këtë semestër (Evidenca 33 dhe 48)</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve.</p> <p>Institucioni ndjek një politikë shumë bashkëpunuese me studentët.</p>
--	---

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët e këtij programi janë informuar në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit, gjë që u evidentua gjatë takimit me studentët. Programet e studimit janë publike edhe në faqen zyrtare web të institucionit.</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë programit të studimit. Gjatë takimit me studentët u informuam se vlerësimet jepeshin nga pedagogët maksimalisht pas një jave nga data e dhënies së provimit. Studentët njoftohen nga Sekretaria ose me email nga pedagogu përkatës.</p> <p>Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve dhe çdo paqartësi që mund të kenë studentët për vlerësimin merret në konsideratë dhe shqyrtohet.</p>
---	---

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim studentëve nëpërmjet zyrës së karrierës. Institucioni ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor. Studentët komunikojnë edhe në mënyrë informale me Dekanin apo Përgjegjësin e departamentit për çdo problematikë që kanë.</p> <p>Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Me Vendim Dekani janë përcaktuar 5 pedagogë për mbikëqyrjen e praktikave profesionale. (Evidenca 39)</p>
---	---

<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurat e pranimit të studentëve në KU Luarasi janë përcaktuar bazuar në udhëzimet e përcaktuara nga MASR, dhe udhëzimet dhe kriteret e përcaktuara nga vetë institucioni. 2. Këshillimi i karrierës ofrohet nga Zyra e karrierës, e cila ndihmon studentët për përzgjedhjen e vendit ku do të zhvillohet praktika profesionale. 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Për studentët e këtij programi studimi disponon të dhëna dhe statistika të semestrit të parë.
--

4. Institucioni ndjek ecurinë e studentëve dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor.
5. Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.
6. Tre anëtarë të zyrës janë trajnuar dhe presin certifikim nga Risi Albania për këshillim karriere (Evidenca nuk është dorëzuar dhe certifikimi pritët në muajin shtator).

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

GVJ konstaton se institucioni është mbështetur tek Strategjia e Kërkimit 2019-2024, për të organizuar dhe vëzhguar kërkimin shkencor dhe rezultatet e tij. Si rezultat i politikës së organizuar të institucionit, nëpërmjet të cilës KU Luarasi ka investuar në rritjen e kapaciteteve, burimeve dhe zhvillimin cilësor të metodologjive të kërkimit, si rezultat i së cilës, pjesa e stafit akademik e angazhuar në kërkim është rritur, ndërsa publikimet e prodhuara kanë qenë të një cilësie më të lartë se më parë.

GVJ konsideron përparësi mbështetjen e kërkimit shkencor ndërdisiplinor mes të gjithë njësive bazë, departamenteve e qendrave kërkimore dhe në partneritet me institucione të tjera kërkimore. KU Luarasi ka përcaktuar fushat prioritare kërkimore mbështetur tek profili i institucionit, interesave kërkimore të stafit sikurse edhe prioriteteve kërkimore të tregut European të kërkimit. Në Evidencën Nr. 30 paraqiten disa shtylla lidhur me veprimtarinë kërkimore.

GVJ konstaton se studentëte programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” janë të përfshirë në kërkim shkencor përmes punimeve të tyre të diplomës sipas Evidencës Nr. 41 “Lista e udhëheqjeve të diplomave”. Nga kjo evidencë vihet re se ka udhëheqës që nuk plotëson kriterin e gradës shkencore për të kryer udhëheqje të punimeve të diplomës. Gjithashtu, nga takimet në institucion por edhe bazuar në dokumentacion rezulton se në lidhje me aktivitetet e organizuara nga njësia kryesore, vetë stafi dhe drejtuesit ndjejnë nevojën e kërkimit në thellësi, më të orientuar drejt temave specifike apo aktiviteteve të profilizuara shkencore të cilat pavarisht botimeve në periodikun “Mendimi” kërkohet të rritet periodiciteti dhe tematikat e zgjedhuralidhur me nevojën për analiza të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, etj.

Njësia organizon edhe trajnime zhvilluese, kryesisht me qëllim nxitjen e zhvillimit të personelit më të ri akademik, sidomos në drejtim të përmirësimit të metodave të mësimdhënies Evidenca Nr.49 dhe mbështet stafin akademik me eksperiencë për kërkimin shkencor Evidenca Nr. 50. Ndonëse kërkimi është individual, KU Luarasi përpiqet që t’u institucionalizojë atë. Krijimi brenda KU Luarasi i një organizate jo fitimprurëse (non profit) e quajtur FAB ka mundur aplikimin në projekte, dhe pritët të japin rezultate.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Nga dokumentat por edhe vizitat dy ditore në institucion u vunë re përpjekje të institucionit dhe drejtuesve të njësive kryesore për më shumë kërkim. Në lidhje me aktivitetet e organizuara nga njësia: vetë stafi dhe drejtuesit ndjejnë nevojën e kërkimit në thellësi, më të orientuar drejt aktiviteteve të profilizuara shkencore të cilat mungojnë, apo një qasje më aktive ndaj përfshirjes së biznesit në këto veprimtari, si edhe nevojën për analiza të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, etj. Imazhi dhe emri i pranueshëm i institucionit nga partnerët në

treg bëjnë të mundur dhe ofrojnë një bazë të qëndrueshme për mbështetjen nga projekte që forcojnë kërkimin, përmirësojnë mësimdhënien dhe i shërbejnë ekonomisë shqiptare. Rekomandohet përfshirje më e madhe cilësore dhe sasiore e studentëve në kërkim, jo vetëm me detyrat e tyre, projektet e kursit por me orientime dhe qasje më të forta drejt bashkëbërjes së projekteve/detyrave me stafet akademike në shërbim të tregut, duke bërë të mundur në këtë mënyrë lidhjen e kërkimit me mësimin.

Rekomandohet (por mbështetet edhe nga drejtuesit e njësive bazë në institucione) se brenda departamentit duhet të nxiten më shumë workshopet dhe eventet e profilizuara ku të përfshihen edhe studentët e MP me detyrat e tyre apo pjesëmarrje në debate. Duhet të bëjnë konferenca/evente të profilizuara sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Rekomandohet që kërkimi shkencor të orientojë e mbështesë promovimin e stafit akademik.

Gjithashtu rekomandohet të përpilohet nga njësia bazë dhe të miratohet nga drejtuesit e KU Luarasi një dokument “Politika e Promovimit dhe Shpërblimit” ku të janë vënë disa piketa se çfarë duhet të përmbushë stafi akademik për t’u promovuar më tej dhe shpërblyer. Drejtuesit e FE dhe njësisë bazë shprehën gjatë vizitave se stafi është i promovuar në forma të ndryshme, por përmes kësaj politike bëhet një formalizim/standardizim për ta bërë më transparent dhe më të matshëm treguesit për progres të çdo pedagogu në njësitë bazë.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

GVJ gjatë vizitës në institucion kërkoi informacion dhe evidenca shtesë për kërkimin shkencor të stafit akademik të FE dhe Njësisë bazë me qëllim evidentimin e ecurisë në vite. Pasi, Tabela Nr. 18, faqe 69 në RVB ka disa tregues shumë të mirë por nuk shprehin ecurinë si edhe çfarë pjesë e tyre i përket FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku”. Në tabelën Nr. 18, faqe 69 të RVB, evidentohen: 25 botime nga PAE i IAL-së. Gjithsesi këto të dhëna nuk rezultojnë të ndarë sipas departamenteve apo stafit akademik. Kjo u plotësua pjesërisht me dokumentin e depozituar në 05 Korrik 2019 pas vizitës në Institucion dhe kërkesës së GVJ: Evidenca e Punës Shkencore të pedagojëve të MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe MP në “Kontabilitet”. Në këtë dokument jepen 10 botime të stafit akademik të lidhur me programin.

Numri i projekteve kërkimore të fituara dhe të zbatuara

Numri i projekteve kërkimore të fituara është 7 sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por ka mungesë të të dhënave se cilat projekte kërkimore i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku”.

Së fundmi, IAL është më i sukseshëm në tregun e projekteve, sepse ka ditur të kapërcejë pengesën ligjore, duke krijuar një OJF, e cila gëzon të drejtën e aplikimit. Universiteti ka intensifikuar përpjekjet për të marrë pjesë në projekte të financuara nga palë të treta dhe nga instrumentat e BE-së. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

KU Luarasi ka organizuar 10 aktivitete shkencore sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave se cilat aktivitete i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe cilat janë ato. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Më shumë se 50 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në këto aktivitete sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave se cilat aktivitete i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe cilat janë ato aktivitete. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

29 është numri i kërkimeve shkencore me procesin mësimor sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave se cilat veprimtari shkencore i përkasin FE dhe njësisë bazë të programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe cilat janë ato kërkime shkencore. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

10 studentë kanë marrë pjesë në kërkimin shkencor sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave se sa studentë i përketin FE dhe njësisë bazë të programit MP "Financë dhe Menaxhim Risku". Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

- Numri i Çmimeve Kombëtare

KU Luarasi ka marrë një çmim kombëtar sipas të dhënave të tabelës Nr. 18, faqe 69 të RVB. Por, RVB ka mungesë të të dhënave nëse ky çmim i përket FE dhe njësisë bazë të programit MP "Financë dhe Menaxhim Risku" dhe për çfarë është fituar ky çmim. Dekani i FE shprehet se nuk ka lidhje fare me programin MP në Kontabilitet. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Për këtë arsye ky çmim nuk është përfshirë në tabelën 18 në shtojcë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>GVJ duke konstatuar mungesë të të dhënave në RVB kërkoi gjatë vizitës në institucion të paraqiten evidenca për publikimet shkencore të personelit akademik të angazhuar në MP "Financë dhe Menaxhim Risku". Sipas dokumentit të depozituar më 05 Korrik 2019 pranë ASCAL evidentohet se FE ka 10 punime shkencore.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Programi nuk ofrohet në gjuhë të huaj.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Bazuar në Evidencën Nr. 49 dhe 50, evidentohen dy tranime të kryera për stafin akademik. Por GVJ nuk evidentoi evidenca të trajnimit të stafit akademik jashtë vendit. Gjatë vizitës në institucion u kërkua nëse njësisia bazë ka informacion tjetër duhet ta vendos në dispozicion. Pyetjes së GVJ se A ofron institucioni mbështetje financiare për trajnimin jashtë vendit të stafin? Institucioni u përgjigj se: Nuk janë kryer por mendohet të ftohen disa ekspertë të huaj dhe të bëjnë trajnim këtu në vend.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>GVJ nuk evidentoi evidenca të drejtëpërdrejtë në RVB për plotësim të kriterëve të standardit III.11. K.U “Luarasi” deklaroi në RVB se disponon një bazë të plotë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij. Por gjatë vizitës në, drejtuesit e tij u shprehën se institucioni po punohet për ndërtimin e një software i cili do të ketë të integruar të dhënat dhe përpunimin e tyre për këtë qëllim, gjithësesi baza e të dhënave sot ruhej në dokumenta fizikë dhe elektronik.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Stafi FE angazhohet në kërkim shkencor dhe rezultojnë me 10 publikime shkencore të personelit akademik të angazhuar në MP “Financë dhe Menaxhim Risku” sipas dokumentit të depozituar më 05 Korrik 2019 pranë ASCAL. 2. Për veprimtarinë kërkimore shkencore është ndërtuar strategjia e kërkimit shkencor për periudhën 2019 – 2014. Pjesë e kësaj strategjie është plani i punës kërkimore shkencore për vitin 2018 – 2019. 3. GVJ konstaton se 8 studentë të programit MP “Finance dhe Menaxhim Risku” janë të përfshirë në kërkim shkencor përmes punimeve të tyre të diplomës sipas Evidencës Nr. 41 “Lista e udhëheqjeve të diplomave”, por nga kjo evidencë vihet re se ka udhëheqës që nuk plotëson kriterin e gradës shkencore për të kryer udhëheqje të punimeve të diplomës. 4. Konstatuar gjatë vizitës në institucion nga vetë stafi akademik se nevojitet kërkim i orientuar drejt temave specifike apo aktiviteteve të profilizuara shkencore të cilat pavarësisht botimeve në periodikun “Mendimi” kërkohet të rritet periodiciteti dhe tematikat e zgjedhuralidhur me nevojën për analiza të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, etj. 5. Institucioni po punon për ndërtimin e një softëare i cili do të ketë të integruar të dhënat për kërkim shkencor dhe përpunimin e tyre, gjithësesi baza e të dhënave sot ruhej në dokumenta fizikë dhe elektronik. 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

KU “Luarasi” e konsideron shumë të rëndësishëm kërkimin shkencor në politikat e tij. Institucioni ka hartuar Scientific Research Strategy 2019-2024 ku ka përcaktuar Bazat e kërkimit dhe objektivat e kërkimit. Institucioni ka në planet strategjike të kërkimit hapjen e shkollës së doktoraturës. Institucioni ka hartuar edhe Planifikimin e Kërkimit Shkencor për vitin akademik 2018-2019 duke synuar krijimin e një sistemi të ri angazhimit, kontraktimit, matjes dhe vlerësimit të punës kërkimore shkencore të anëtarëve të personelit akademik. Kolegji Universitar “Luarasi” ka hapur thirrjen për Projekte Kërkimore Individuale/nëgrup për vitin akademik 2018-2019.

Ku “Luarasi” ka zhvilluar në vitet e fundit Konferencë Ndërkombëtare dhe punimet e prezantuara aty janë botuar edhe në Revistën shkencore “Mendimi” që boton institucioni.

Nëpërmjet Konferencës Ndërkombëtare dhe Revistës “Mendimi” institucioni ka mbështetur dhe nxitur kërkimin shkencor të stafit akademik. Në buxhetin e Institucionit parashikohet cdo vit zëri për kërkimin shkencor për mbulimin e Konferencës ndërkombëtare dhe botimin e revistës “Mendimi”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare

Aktualisht Fakulteti Ekonomik dhe vecanërisht pedagogët efektiv të këtij programi studimi nuk janë pjesë e projekteve Kombëtare apo ndërkombëtare.

- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj

KU "Luarasi" fton vazhdimisht lektorë të huaj dhe vendas që zhvillojnë leksione të hapura apo trajnime dhe në këto aktivitete marrin pjesë edhe pedagogët edhe studentët e këtij programi studimi. Në tabelën 19. Jepen 5 orë mësimi me lektorë të huaj. Pas kërkesës së dokumentacioneve nga GVJ institucioni ka ngarkuar dokumentin Aktivitete dhe leksione të hapura, por është një dokument që nuk evidenton nëse këto aktivitete janë zhvilluar në vitin akademik 2018-2019, dhe në disa raste pa specifikuar Lektorin përkatës.

- Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit

Asnjë pjesëmarrës në trajnime jashtë vendit për kërkimin shkencor

- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL

Në tabelën 19 jepet se 1 student ka zhvilluar mobilitet por gjatë vizitës u informuam se KU "Luarasi" është pjesë e rrjetit ERASMUS por deri tani nuk ka pasur mobilitete pedagogësh apo studentësh për këtë program studimi.

- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor

2 laboratore

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Asnjë pjesëmarrës në aktivitete shkencore jashtë IAL apo jashtë vendit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

KU "Luarasi" ka lidhur 7 marrëveshje me Institucione të ndryshme publike dhe private si dhe 6 marrëveshje me universitete vendase dhe të huaj. Konferenca Nderkombëtare e zhvilluar në maj 2019 është organizuar në bashkëpunim me disa institucione, universitete dhe fakultete.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Aktivitete dhe leksione të hapura

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	

<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p>	<p>Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione publike dhe privat,. Për realizimin e programit të studimeve ka nënshkruar 3 (tre) marrëveshje për bashkëpunim me Institucione publike: “Kontrolli i Lartë i Shtetit”, “Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare” (AMF), Ministria për “Inovacionin dhe Administratën Publike” dhe 4 (kater) me komunitetin e biznesit (tregu i punës), keto të fundit kryesisht banka. (Evidenca 37)</p> <p>Në total janë 7 marrëveshje dhe janë në nivel Institucionidhesi rrjedhim institucioni duhet të bëjë më shumë për lidhje marrëveshje me ndërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë nisur nga pritshmëria për rritje të numrit të studentëve.</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni që në hartimin e programit të studimit ka nxitur bashkëpunimin ndërmjet personelit, nëpërmjet diskutimeve dhe realizon mbikëqyrjen duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet pedagogëve, përgjegjësit të departamentit, njësisë së NJSBC, etj.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive mes personelit dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, si të pedagogëve ashtu edhe të stafit ndihmës garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga evidencat që disponojmë konkludojmë se institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. (Evidenca 37)</p> <p>Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron.</p> <p>Nga takimi në Institucion na u tha se janë zhvilluar trajnime për studentët por kjo nuk evidentohet me dokumenta.</p> <p>Nga evidencat nuk kemi informacion në lidhje me raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale, por programi i studimit është në vitin e parë të tij ndaj mbetet për të parë përfitimet në vitet e ardhshme.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. KU “Luarasi” në politikat e tij zhvillimore e konsideron shumë të rëndësishëm kërkimin shkencor, institucioni ka hartuar Scientific Research Strategy 2019-2024. 2. Institucioni ka 7 marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, që mund ti shfrytëzojë për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve. Institucioni duhet të lidh më shumë marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë, etj. 3. Institucioni për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit ka nxitur krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit për të garantuar cilësi në këtë program studimi. 	

ANALIZA SWOT PËR PROGRAMIN E STUDIMIT MP NË ‘FINANCË DHE MENAXHIM RISKU’

Pika të forta:

1. Staf i akademik është i motivuar dhe me përvojë profesionale dhe akademike
2. Infrastruktura mësimore është cilësore dhe bashkëkohore
3. Zyra e karrierës, studentit, alumnit, klubet dhe të tjera njësi mbështetëse kanë staf energjik, të përkushtuar me ide dhe plane të qarta për mbështetjen e tyre.
4. Pozicionimi pranë Qytetit i shërben mirë qëllimit të ofrimit të programeve të studimeve master për studentët.
5. Literatura e përditësuar kryesisht në anglisht mbështet programet e studimit master.
6. Marrëdhënia e ngushtë ndërmjet studentëve, pedagogëve dhe drejtuesve. Kjo edhe për shkak të numrit të ulët të studentëve.
7. Publiciteti i vazhdueshëm ka krijuar imazh pozitiv tek publiku.

Pika të dobëta:

1. Numri i pamjaftueshëm i pedagogëve me tituj akademik të kategorisë “Profesor” për të mbuluar të gjitha lëndët e programit të studimit sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3.
2. Mungesa e buxhetit të dedikuar për të mbështetur zhvillimin shkencor të pedagogëve me qëllimin rritjen e financimit për kërkimin shkencor nga institucioni (kjo e rekomanduar edhe në pikën 2 “Afirmime për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë” në shtojcën e Vendimit nr. 115, datë 15.12.2017 të ASCAL për akreditimin e IAL KU Luarasi).
3. Asimetria e informacionit evidentohet në RVB, evidencat e depozituara në ASCAL dhe disa prej komenteve të institucionit për draft RVJ-në.
4. Mungesa e lëndëve profesionale nga fusha fiskale, sigurimet dhe fondet e investimeve dhe pensione.
5. Mungesa e ambienteve sportive dhe rekreative në Institucion.

Mundësitë:

1. Përfshirja e studentëve të programit të studimit në aktivitetet studentore kombëtare apo ndërkombëtare, si një mënyrë e mirë promovimi.
2. Lidhja e më shumë marrëveshje bashkëpunimi me bizneset e industrive respektive në mënyrë që të shfrytëzojnë ato për praktikat profesionale dhe punësimin me qëllim forcimin dhe promovimin e rrjetit alumnit.
3. Përfshirja e pedagogëve të departamentit të Financë Bankës në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare
4. Pasurimi bibliotekës me literaturë të përditësuar në gjuhën shqip.
5. Aplikimi në projekte ndërkombëtare për të siguruar fonde përveç të ardhurave nga tarifat studentore.
6. Përditësimi i syllabuseve në funksion të përputhshmërisë me nevojat e tregut

Pengesat:

1. Disa universitete ofrojnë programe studimi të ngjashme
2. Mbështetja vetëm në të ardhurat nga tarifat studentore ndërkohë që numri i studentëve është i ulët.
3. Rreziku i humbjes së PAE me tituj ose gradë shkencore si rezultat i konkurrencës.

Rekomandimet:

1. Të rritet numri i stafit akademik të brendshëm me grada dhe tituj shkencor dhe për rekrutimet të mbahet parasysh Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015, neni 59, pika 3) në lidhje me titullarët e lëndëve.
2. Të sigurohet publikimi i Raportit Vjetor me qëllim plotësimin e standardit I.13 ku kërkohet për publikimin rregullisht të informacionit të paanshëm, objektiv, sasior dhe cilësor të shoqëruar me tregues konkretë për matjen e këtyre treguesve, kjo edhe në zbatim të kërkesës së Nenit 11 të rregullores së Programit MP “Financë dhe Menaxhim Risku”.

3. Të rritet numri i moduleve të profilit të menaxhimit të riskut, fiskale, sigurimet dhe fondet e investimeve dhe pensione në mënyrë që programi i studimit të përmbushë objektivat formuese.
4. Të rrisë buxhetin e dedikuar për kërkimin shkencor të pedagogëve për promovimin e tyre dhe të institucionit në evente shkencore.
5. Të sigurohet simetria e informacionit në raportet dhe dokumentacionin respektiv për këtë program studimi.

SWOT

Strengths:

1. Academic staff is motivated and with professional and academic experience.
2. The teaching infrastructure is qualitative.
3. Career office, student, alumni, clubs and other support units are energized, committed to clear tire delivery ideas and plans.
4. The location near “Qyteti Studenti” serves well to the purpose of providing Master Programs to students.
5. Literature updated mainly in English supports master study programs.
6. The close relationship between students, lecturers and leaders. This is also due to the low number of students.
7. Continuous publicity has created a positive image for the public.

Weak points:

1. Insufficient number of pedagogues with academic titles of “Professor” category to cover all subjects of study program according to Law no. 80/2015, dated 22.07.2015 “On Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania”, Article 59, paragraph 3.
2. Lack of a dedicated budget to support the scientific development of pedagogues with the aim of increasing funding for scientific research by the institution (this is also recommended in point 2 “Affirmations for further quality improvement” in annex to Decision No. 115, dated 15.12.2017 of ASCAL for accreditation of HEI KU Luarasi).
3. Asymmetry of information is evidenced in the Internal Evaluation Report, and evidences deposited in ASCAL, and some of the institution's comments on the draft External Evaluation Report.
4. Lack of professional subjects in the fiscal field, insurance and investment and pension funds.
5. Lack of sports and recreational facilities in HEI.

Opportunities:

1. The inclusion of students of this study program into national or international student activities as a good way of promotion.
2. Signing of more collaboration agreements with businesses of the respective industries in order to utilize them for professional practices and employment in order to strengthen and promote alumni network.
3. Involvement of pedagogues of Finance Bank department in national and international projects.
4. Enriching the library with updated literature in Albanian language.
5. Applying to international projects to secure funding in addition to student tuition fees.
6. Updating syllabuses to meet market needs

Threats:

1. Some other universities offer similar study programs
2. Reliance only on student tuition fees while the number of students is low.
3. Risk of losing the effective (internal) pedagogues with titles or scientific degrees as result of competition.

Recommendations:

1. To increase the number of in-house academic staff with scientific degrees and titles of category “Professor” and take into account Law no. 80/2015, dated 22.07.2015, article 59, point 3) in relation to the titular of the subject.
2. To ensure the publication of the Report for the purpose of fulfilling Standard I.13 where it is required for the regular publication of impartial, objective, quantitative and qualitative information accompanied by concrete

indicators for measuring these indicators, also in accordance with the requirement of Article 11 of the MP Program Regulation "Finance and Risk Management"

3. To increase the number of risk management, fiscal, insurance, investment and pension profile modules so that the study program meets better the formative objectives.

4. To increase the budget dedicated to the research of pedagogues for their promotion and the scientific events of HEI.

5. To ensure symmetry of information in the respective reports, evidences and documentation for this study program.

Përbërja e GVJ:

1. Prof. As. Dr. Etleva Bajrami

2. Prof. As. Dr. Artur Ribaj

